



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 54

Tiranë – E premte, 8 prill 2022

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 28/2022, datë 31.3.2022	Për zgjedhjen e zonjës Natasha Ahmetaj anëtare e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë..... 7609
Vendim i Kuvendit nr. 29/2022, datë 31.3.2022	Për zgjedhjen e zotit Anastas Angjeli anëtar të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë..... 7609
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 196, datë 6.4.2022	Për një shtesë në vendimin nr. 102, datë 16.2.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës e të niveleve të pagave të pozicioneve koordinator të Rrjetit të Koordinatorëve kundër Korrupsionit në disa institucione të administratës shtetërore”..... 7609
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 197, datë 6.4.2022	Për kalimin të bashkitë Durrës, Kavajë, Kamzë, Krujë dhe Kurbin të objekteve arsimore..... 7611
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 198, datë 6.4.2022	Për një ndryshim në vendimin nr. 83, datë 31.1.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e zonës së re për zhvillim në Njësinë Administrative Ndroq, Bashkia Tiranë, dhe caktimin e Bashkisë Tiranë si njësi zbatuese”..... 7612
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 199, datë 6.4.2022	Për kalimin të bashkitë Tiranë dhe Krujë të njësive të banimit në ndërtesa (pallat)..... 7613
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 200, datë 6.4.2022	Për disa shtesa në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian, për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara”, të ndryshuar 7614
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 201, datë 6.4.2022	Për kushtet, kriteret dhe afatet për përcaktimin e procedurës së përshpejtuar për shqyrtimin e kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare 7661
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 202, datë 6.4.2022	Për lirimin dhe emërimin në detyrë të prefektit të qarkut të Lezhës. 7662

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 203, datë 6.4.2022	Për lirim dhe emërimin në detyrë të prefektit të qarkut të Durrësit.....	7662
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 205, datë 6.4.2022	Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave të aplikimit, të rregullave të kryerjes së verifikimeve dhe kontrolleve të nevojshme për fitimin e shtetësisë shqiptare për kontribut të veçantë në fushën e arsimit, shkencës dhe sportit.....	7662
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 206, datë 6.4.2022	Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Përfundimi i punimeve të mbetura dhe plotësimi me rrugë dytësore, nyja e Milotit”.....	7665
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 208, datë 6.4.2022	Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurës për përfitimin e mbrojtjes së veçantë të garantuar nga shteti për përkthyesit zyrtarë dhe interpretët e gjuhës së shenjave.....	7670
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 211, datë 6.4.2022	Për miratimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim notash të marrëveshjes së grantit ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, dhe Fondit Global për të Luftuar SIDA-n, tuberkulozin dhe malarin, për programin “Përshkallëzimi dhe sigurimi i qëndrueshmërisë së përgjigjes kombëtare ndaj HIV/SIDA-s dhe tuberkulozit, në grupet kryesore të popullatës”, miratuar me vendimin nr. 219, datë 12.3.2020, të Këshillit të Ministrave.....	7672
Urdhër i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 158, datë 28.3.2022	Për miratimin e standardeve profesionale për drejtuesit e institucioneve arsimore parashkollore.....	7677
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 153, datë 1.4.2022	Për ndalimin e peshkimit në liqenin e Shkodrës.....	7687
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 154, datë 1.4.2022	Për marrjen e masave kufizuese për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjes së influencës aviare në shpendë, në mjediset e hapura dhe në tregjet e kafshëve të gjalla.....	7688
Urdhër i ministrit të Brendshëm nr. 47, datë 2.4.2022	Për delegim kompetence	7689
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 8, datë 3.3.2022	Me objekt konstatimin e shkeljes të së drejtës kushtetuese të aksesit dhe të sigurisë nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës, Gjykata Administrative e Apelit, si dhe Gjykata e Lartë. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2021-386, datë 18.3.2021, të Gjykatës së Lartë dhe kthimin e çështjes për gjykim në Gjykatën Administrative të Apelit.....	7689

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 47, datë 23.3.2022	Mbi pajisjen me certifikatë të garancisë së origjinës për impiantin e prodhimit të energjisë elektrike HEC “Banjë”, të shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a., për periudhën 1.1.2021–31.12.2021.....	7694
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 48, datë 23.3.2022	Mbi shtyrjen e vendimarrjes së Bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë “HERA” sh.p.k., për transferimin e plotë të licencës nr. 49, seria NPM07P, dhënë me vendimin e Bordit nr. 61, datë 2.11.2007, “Për ndërtim, instalim, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale me erë (projekti KAPPET)”, të ndryshuar.....	7695
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 49, datë 23.3.2022	Mbi shtyrjen e afatit të vendimarrjes së Bordit të ERE-s mbi aplikimin e shoqërisë “Karavasta Solar” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai, me vendndodhje në zonën e Remasit – Karavasta, Lushnjë dhe Libofshë, Fier, me kapacitet të instaluar 140 mw.....	7696
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 213/5, datë 5.4.2022	Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksioni i segmentit Shkodër (mbikalimi i trenit) – Mes”.....	7697
Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë nr. 1(64-2022-95), datë 25.1.2022	Për heqjen e zotësisë për të vepruar për shtetasen Arvena Akulli.....	7698
Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër nr. 6(1013), datë 21.3.2022	Për marrjen e masës urgjente të përkohshme, të caktimit të kujdestarit ligjor për shtetasen Elvira Marinaj.....	7698
	Ndreqje gabimi material në ligjin nr. 10/2022, datë 27.1.2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9863, datë 28.1.2008, ‘Për ushqimin’, të ndryshuar”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 29, datë 22.2.2022.....	7698
	Ndreqje gabimi material në ligjin nr. 11/2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10465, datë 29.9.2011, ‘Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë’, të ndryshuar”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 29, datë 22.2.2022.....	7698

**VENDIM**
Nr. 28/2022**PËR ZGJEDHJEN E ZONJËS NATASHA AHMETAJ ANËTARE E KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË BANKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 44, pikat 2 dhe 3, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**VENDOSI:**

I. Zonja Natasha Ahmetaj zgjidhet anëtare e Këshillit Mbiqëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDESKRYETARE
Ermonela Felaj (Valikaj)

Miraturar më datë 31.3.2022.

VENDIM
Nr. 29/2022**PËR ZGJEDHJEN E ZOTIT ANASTAS ANGJELI ANËTAR TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË BANKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 44, pikat 2 dhe 3, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**VENDOSI:**

I. Zoti Anastas Angjeli zgjidhet anëtar i Këshillit Mbiqëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDESKRYETARE
Ermonela Felaj (Valikaj)

Miraturar më datë 31.3.2022.

VENDIM
Nr. 196, datë 6.4.2022**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 102, DATË 16.2.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS E TË NIVELEVE TË PAGAVE TË POZICIONEVE KOORDINATOR TË RRJETIT TË KOORDINATORËVE KUNDËR KORRUPSIONIT NË DISA INSTITUCIONE TË ADMINISTRATËS SHTETËRORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, dhe të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 5, të vendimit nr. 102, datë 16.2.2022, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 5/1, me këtë përmbajtje:

“5/1. Nëpunësit në pozicionet “koordinator” të Rrjetit të Koordinatorëve kundër Korrupsionit në institucionet, pjesë e fushës së veprimit të këtij vendimi, përveç pagës mujore të përcaktuar në lidhjet nr. 1/1, nr. 1/2, nr. 2/1 dhe nr. 2/2, përfitojnë shtesën mujore për natyrë të veçantë pune, sipas përcaktimit në lidhjen nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i secilit institucion, pjesë e fushës së veprimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



Lidhja nr. 3

SHITESA MUJORE PËR NATYRË TË VEÇANTË PUNE
PËR NËPUNËSIT NË POZICIONET “KOORDINATOR”, PJESË E RRJETIT TË
KOORDINATORËVE KUNDËR KORRUPSIONIT PËR INSTITUCIONET QË JANË PJESË E
FUSHËS SË VEPRIMIT TË KËTIJ VENDIMI

POZICIONI KOORDINATOR, NË:	SHITESA MUJORE PËR NATYRË TË VEÇANTË PUNE
- Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës - Drejtoritë vendore të kategorisë së parë të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës - Drejtoritë vendore të kategorisë së dytë të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës	18.000
- Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve - Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave	15.000
- Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit - Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura - Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit - Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara	10.000
- Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” - Spitalin Obsetrik Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë” - Spitalin Universitar të Traumës. - Spitalin Universitar Obsetrik Gjinekologjik “Koço Glozheni” - Spitalin Universitar “Shefqet Ndroqi”. - Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore - Spitalin Psikiatrik “Ali Mihal” , Vlorë - Spitalin Psikiatrik “Sadik Dinci”, Elbasan - Spitalet rajonale - Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile - Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore - Agjencinë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural - Drejtorinë e Përgjithshme të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit - Drejtorinë Qendrore të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit - Drejtorinë Qendrore të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor - Drejtorinë Qendrore të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar - Agjencinë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë - Agjencinë e Blerjeve të Përqendruara - Autoritetin Rrugor Shqiptar në nivel qendror - Institutin e Shëndetit Publik - Inspektoratin Shtetëror Shëndetësor në nivel qendror - Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial - Shërbimin Social Shtetëror në nivel qendror - Drejtoritë rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor - Drejtoritë rajonale të Arsimit Parauniversitar	5.000



VENDIM
Nr. 197, datë 6.4.2022

**PËR KALIMIN TE BASHKITË DURRËS,
KAVAJË, KAMZË, KRUIJË DHE KURBIN
TË OBJEKTEVE ARSIMORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 20, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin te bashkitë Durrës, Kavajë, Kamzë, Krujë dhe Kurbin të 13 (trembëdhjetë) objekteve arsimore, sipas listës së inventarit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Zëvendëskryeministri dhe ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave dhe bashkitë Durrës, Kavajë, Kamzë, Krujë dhe Kurbin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Listë Inventari për objektet arsimore													
Nr.	Qarku	Bashkia	Njësia Administrative	Niveli	Emërtimi	Tipologjia e Ndërhyrjes	Financimi i Ndërtimit	Sipërfaqe (m2)	Vlera e Projekt Idesë	Vlera e projektit të zbatimit dhe ndërtimit	Vlera e Mblqyrjes	Vlera e koaludimit	Vlera totale e objektit
1	Lezhë	Kurbin	Milot	9-vjeçar	Rindërtimi dhe riparimi i Shkolles 9-vjeçare "Cub Capani", Malbardhë, Bashkia Kurbin	Rindërtim + Riparim	Bashkimi European	893	1,024,157	44,403,123	1,731,688	146,824	47,305,792
2	Lezhë	Kurbin	Laç	9-vjeçar	Rindërtimi dhe riparimi i Shkolles 9-vjeçare "Gjokë Elez" Sanxhak- Laç, Bashkia Kurbin	Rindërtim	Bashkimi European	3,687	1,024,157	167,837,867	1,731,688	548,164	171,141,876
3	Lezhë	Kurbin	Milot	9-vjeçar	Rindërtimi dhe riparimi i Shkolles 9-vjeçare "28 Nentori", Fushë Milot, Bashkia Kurbin	Riparim	Bashkimi European	1,700	1,024,157	93,941,190	1,731,688	241,034	96,938,069
4	Durrës	Krujë	Krujë	1 mesëm	Riparimi dhe përforcimi i Gjimnazit "Skënderbeu", Bashkia Krujë	Riparim	Bashkimi European	1,767	393,033	102,505,651	1,610,180	282,138	104,791,002
5	Tiranë	Kamëz	Kamëz	9-vjeçar + kopësht	Rindërtimi i Shkolles dhe i Kopështit "Dom Nikollë Kaçori", Bashkia Kamëz	Rindërtim + Riparim	Bashkimi European-Projekti EU4Schools	2,477	943,899	134,542,723	1,278,788	345,274	137,110,683
6	Durrës	Krujë	Nikel	9-vjeçar	Rindërtimi dhe riparimi i Shkolles "Korb Muça"	Rindërtim	Bashkimi European-Projekti EU4Schools	2,794	642,273	216,036,832	2,348,083	459,379.00	219,486,567
7	Durrës	Krujë	Bubq	9-vjeçar	Rindërtimi dhe riparimi i Shkolles 9-vjeçare "Sherif Dervishi"	Rindërtim	Bashkimi European-Projekti EU4Schools	1,899	642,273	152,913,649	2,348,083	312,227.00	156,216,232
8	Lezhë	Kurbin	Mamurras	9-vjeçar	Riparimi dhe Përforcimi i Shkolles 9-vjeçare "Demokracia"	Riparim	Bashkimi European-Projekti EU4Schools	996	1,024,157	42,786,274	1,731,687.50	163,759.00	45,705,878
9	Durrës	Krujë	Thumane	9-vjeçar	Riparimi dhe Përforcimi i Shkolles 9-vjeçare "Shaqir Uleja"	Riparim	Bashkimi European-Projekti EU4Schools	973	393,032.73	76,482,108	1,610,180.00	140,412.00	78,625,733
10	Durrës	Durrës	Durrës	Kopësht	Riparimi dhe përforcimi i kopështit "I Qershori"	Riparim dhe përforcim	Bashkimi European-Projekti EU4Schools	708	51,122,871.00	40,385,594.41	340,584	111,803	40,837,981.41
11	Durrës	Durrës	Durrës	1 mesëm profesional	Riparimi dhe përforcimi i Shkolles "Hysen Çela"	Riparim dhe përforcim	Bashkimi European-Projekti EU4Schools	4574	43,519,201.00	56,100,334.43	2,200,326	711,101	59,011,761.43
12	Tiranë	Kavajë	Kavajë	9-vjeçar	Riparimi dhe përforcimi i Shkolles 9-vjeçare "Mehmet Babamusta"	Riparim dhe përforcim	Bashkimi European-Projekti EU4Schools	2700	173,223,200.66	119,489,328.00	1,023,030.00	369,937	120,882,295.00
13	Tiranë	Kavajë	Kavajë	9-vjeçar	Riparimi dhe përforcimi i Shkolles 9-vjeçare "Faqiri Kurti"	Riparim dhe përforcim	Bashkimi European-Projekti EU4Schools	3100	171,680,506.57	112,549,154.33	1,023,030.00	320,612	962,668,131.83
TOTALI								28,268.0	443,584,446.3	1,053,791,647.3	15,513,971.7	3,216,642.0	1,516,134,975.3



VENDIM
Nr. 198, datë 6.4.2022

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 83, DATË 31.1.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPALLJEN E ZONËS SË RE PËR ZHVILLIM NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NDROQ, BASHKIA TIRANË, DHE CAKTIMIN E BASHKISË TIRANË SI NJËSI ZBATUESE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “iii” e “iv”, e 16, pika 3, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për

Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave


VENDOSI:

1. Harta dhe koordinatat, që i bashkëlidhen vendimit nr. 83, datë 31.1.2020, të Këshillit të Ministrave, ndryshohen, përkatësisht, me hartën dhe koordinatat bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama





VENDIM
Nr. 199, datë 6.4.2022

**PËR KALIMIN TE BASHKITË TIRANË
DHE KRUIJË TË NJËSIVE TË BANIMIT
NË NDËRTESE (PALLAT)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 9, të nenit 19, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin te bashkitë Tiranë dhe Krujë të njësisve të banimit në ndërtesa (pallat), sipas anekseve 1 dhe 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohen Zëvendëskryeministri dhe ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe bashkitë Tiranë dhe Krujë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

**LISTA E INVENTARIT TË OBJEKTEVE KOLEKTIVE TË PËRFUNDUARA NË ZONËN “5
MAJI” (TË KOLAUDUARA)**

Nr.	Emërtimi i kontratës	Objekti	Vlera e objektit sipas kontratës	Vlera e situacionit për punimet e kolauduara	Sipërfaqja totale e ndërtimit (i kolauduar) (m ²)	Hapësirë e përbashkët	Sipërfaqja e banimit (m ²)	Tipologjitë e apartamenteve			
								Ap. 1+1	Ap. 2+1	Ap. 3+1	Total apartamente (nr.)
1	Hartimi i projektit dhe zbatimi i punimeve për ndërtimin e godinës 15A (seksioni 2) në zonën zhvillimore “5 Maji”	Godina 15A (seksioni 2)	279,000,000	227,187,387	3335	522	2813	4	14	8	26
2	Hartimi i projektit dhe zbatimi i punimeve për ndërtimin e godinës 15A (seksioni 3) në zonën zhvillimore “5 Maji”	Godina 15A (seksioni 3)	545,660,000	241,541,913	3256.8	544	2713.2	12	12	4	28
3	Hartimi i projektit dhe zbatimi i punimeve për ndërtimin e godinës 19, në zonën zhvillimore “5 Maji”	Godina 19	408,825,570	180,681,773	2844.8	534	2310.4	32			32
Totali			1,233,485,570	649,411,072	9436.6	1,600	7836.6	48	26	12	86

Banesa Kolektive Njësia Administrative Bubq													
Nr.	Qarku	Bashkia	Njësia Administrative	Emërtimet	Sipërfaqja totale objekti (m ²)	Vlera e objekti sipas kontrates (All)	Kosto mesatare ndërtimi (All/m ²)	Sipërfaqja Sherbimesh (m ²)	Sipërfaqja Banimi (m ²)	Tipologjitë e apartamenteve			
										Ap. 1+1	Ap. 2+1	Ap. 3+1	TOTAL APARTAMENTE
1	Durrës	Krujë	Bubq	Objekti A	651.6	27,016,385.46	41,461.61	-	651.60	6	3	0	9
2	Durrës	Krujë	Bubq	Objekti B1	588.0	24,379,427.03	41,461.61	-	588.00	3	0	3	6
3	Durrës	Krujë	Bubq	Objekti B2	588.0	24,379,427.03	41,461.61	-	588.00	3	0	3	6
4	Durrës	Krujë	Bubq	Objekti B3	588.0	24,379,427.03	41,461.61	-	588.00	3	0	3	6
5	Durrës	Krujë	Bubq	Objekti C1	588.0	24,379,427.03	41,461.61	-	588.00	0	6	0	6
6	Durrës	Krujë	Bubq	Objekti C2	588.0	24,379,427.03	41,461.61	-	588.00	0	6	0	6
7	Durrës	Krujë	Bubq	Objekti C3	588.0	24,379,427.03	41,461.61	-	588.00	0	6	0	6
Totali					4,179.6	173,292,947.62	290,231.27	-	4,179.60	15	21	9	45



VENDIM

Nr. 200, datë 6.4.2022

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.
1128, DATË 30.12.2020, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR ZBATIMIN NGA
REPUBLIKA E SHQIPËRISË TË
VENDIMEVE TË KËSHILLIT TË
BASHKIMIT EVROPIAN, PËR
VENDOSJEN, NDRYSHIMIN DHE
SHFUQIZIMIN E MASAVE
SHTRËNGUESE NDËRKOMBËTARE,
TË NDRYSHUARA”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, pika 3, shkronja “c”, dhe 6, pikat 2 e 5, të ligjit nr. 72/2019, “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

1. Në kreun I bëhen këto shtesa:

a) Në pikën 7, pas fjalëve “... (CFSP) 2022/397, ...” shtohen “... (CFSP) 2022/241, (CFSP) 2022/429 ...”;

b) Në pikën 25, pas fjalëve “... (CFSP) 2022/395, ...” shtohen “... (CFSP) 2022/430 ...”.

2. Në aneksin 7, bashkëlidhur vendimit, shtohen vendimet (CFSP) 2022/241 dhe (CFSP) 2022/429, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

3. Në aneksin 25, bashkëlidhur vendimit, shtohet vendimi (CFSP) 2022/430, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

II. Ngarkohen organet e parashikuara në pikën 1, të nenit 11, të ligjit nr. 72/2019, “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**



21.2.2022

SHQ

VENDIM I KËSHILLIT (CFSP) 2022/241

e datës 21 shkurt 2022

për ndryshimin e Vendimit 2014/145/CFSP në lidhje me masat kufizuese në lidhje me veprimet që cenojnë ose kërcënojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Bashkimin Evropian, dhe në veçanti nenin 29 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit për Punë të Jashtme dhe Politikë

të Sigurisë, duke pasur parasysh:

- (1) Më 17 mars 2014, Këshilli miratoi Vendimin 2014/145/CFSP⁽¹⁾.
- (2) Bashkimi Evropian nuk njeh dhe vazhdon të dënojë aneksimin e paligjshëm të Krimesë dhe Sevastopolit nga Federata Ruse dhe për këtë arsye nuk njeh të ashtuquajturat zgjedhje të mbajtura në gadishullin e Krimesë të aneksuar ilegalisht.
- (3) Pas organizimit, nga Federata Ruse, të të ashtuquajturave zgjedhje për Dumën e Shtetit në "Republikën Autonome të Krimesë" të aneksuar ilegalisht dhe në qytetin e Sevastopolit në shtator 2021, Këshilli konsideron se pesë individë duhet të shtohen në listën e personave, subjektet dhe organet që i nënshtrohen masave kufizuese të përcaktuara në Aneksin e Vendimit 2014/145/CFSP për rolin e tyre në cenimin ose kërcënimin e integritetit territorial, sovranitetit dhe pavarësisë së Ukrainës.
- (4) Prandaj, Aneksi i Vendimit 2014/145/CFSP duhet të ndryshohet në përputhje me rrethanat,

KA MIRATUAR KËTË VENDIM:

Neni 1

Personat e listuar në Aneksin e këtij Vendimi do t'i shtohen listës së përcaktuar në Aneksin e Vendimit 2014/145/CFSP.

Neni 2

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Bërë në Bruksel, më 21 shkurt 2022.

*Për Këshillin**Presidenti*

J. BORRELL FONTELLES

(¹)Vendimi i Këshillit 2014/145/CFSP i 17 marsit 2014 në lidhje me masat kufizuese në lidhje me veprimet që cenojnë ose kërcënojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës (OJ L 78, 17.3.2014, f. 16).



L 40/24

SHQ

Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian

21.2.2022

ANEKSI

Personat e mëposhtëm i shtohen listës së personave, subjekteve dhe organeve të përcaktuara në Aneksin e Vendimit 2014/145/CFSP:

Emri	Informacion identifikues	Arsye	Data e listimit
204. Aleksei Yurievich CHERNIAK (Алексей Юрьевич ЧЕРНЯК)	Gjinia: Mashkull Datëlindja: 27.8.1973 POB: Alma-Ata, SSR e Kazakistanit (tani Kazakistan) Kombësia: Ruse	Anëtar i Dumës Shtetërore të Federatës Ruse që nga 19 shtatori 2021. I zgjedhur nga "Republika Autonome e Krimesë" e aneksuar ilegalisht në të ashtuquajturën "Elektorati Simferopol". Anëtar i partisë në pushtet Rusia e Bashkuar. Duke marrë pjesë për dhe duke vepruar në këtë cilësi, ai ka punuar për integrimin e mëtejshëm të ashtuquajturës "Republika e Krimesë" në Federatën Ruse dhe në këtë mënyrë ka mbështetur në mënyrë aktive veprime dhe politika të zbatuara që minojnë ose kërcënojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës.	21.2.2022
205. Leonid Ivanovich BABASHOV (Леонид Иванович БАБАШОВ)	Gjinia: Mashkull Datëlindja: 31.1.1966 POB: Petrovka, Rajoni i Krimesë, SSR e Ukrainës (tani Ukraina)	Anëtar i Dumës Shtetërore të Federatës Ruse që nga 19 shtatori 2021. I zgjedhur nga "Republika Autonome e Krimesë" e aneksuar ilegalisht në të ashtuquajturën "Elektoratin Yevpatoria". Anëtar i partisë në pushtet Rusia e Bashkuar. Duke marrë pjesë për dhe duke vepruar në këtë cilësi, ai ka punuar për integrimin e mëtejshëm të ashtuquajturës "Republika e Krimesë" në Federatën Ruse dhe në këtë mënyrë ka mbështetur në mënyrë aktive veprime dhe politika të zbatuara që minojnë ose kërcënojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës.	21.2.2022
206. Tatiana Georgievna LOBACH (Татьяна Георгиевна ЛОБАЧ)	Gjinia: Femër Datëlindja: 8.1.1974 POB: Khmelnytskyi, SSR e Ukrainës (tani Ukraina)	Anëtar i Dumës Shtetërore të Federatës Ruse që nga 19 shtatori 2021. I zgjedhur nga qyteti i aneksuar ilegalisht i Sevastopolit në të ashtuquajturën "Elektorale Sevastopol". Anëtar i partisë në pushtet Rusia e Bashkuar. Duke marrë pjesë për dhe duke vepruar në këtë cilësi, ajo ka punuar për integrimin e mëtejshëm të qytetit të aneksuar ilegalisht të Sevastopolit në Federatën Ruse dhe në këtë mënyrë ka mbështetur në mënyrë aktive veprime dhe politika të zbatuara që minojnë ose kërcënojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës.	21.2.2022



21.2.2022

SHQ

Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian

L 40/25

	Emri	Informacion Identifikues	Arsye	Data e listimit
207.	Nina Sergeevna FAUSTOVA (Нина Сергеевна ФАУСТОВА)	Gjinia: Femër Datëlindja: 11.7.1983 POB: Kyzyl, Republika e Tuvës, SFSR Ruse (tani Federata Ruse)	Kreu i komisionit zgjedhor të Sevastopolit, i cili mori pjesë në organizimin e të ashtuquajturave zgjedhje në "Republikën Autonome të Krimesë" të aneksuar ilegalisht dhe qytetin e Sevastopolit të mbajtura në shtator 2021. Duke marrë pjesë për dhe duke vepruar në këtë cilësi, ajo mbështeti dhe zbatoi në mënyrë aktive veprime dhe politika që minojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës dhe destabilizuan më tej Ukrainën.	21.2.2022
208.	Aleksandr Evgenovich CHMYHALOV (Александр Евгеньевич ЧМЫХАЛОВ)	Gjinia: Mashkull Datëlindja: 13.6.1990	Nënkryetari i komisionit zgjedhor të Sevastopolit, i cili mori pjesë në organizimin e të ashtuquajturave zgjedhje në "Republikën Autonome të Krimesë" të aneksuar ilegalisht dhe në qytetin e Sevastopolit të mbajtura në shtator 2021. Anëtar i partisë në pushtet "Rusia e Bashkuar". Duke marrë pjesë për dhe duke vepruar në këtë cilësi, ai mbështeti dhe zbatoi në mënyrë aktive veprime dhe politika që minojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës dhe destabilizuan më tej Ukrainën.	21.2.2022.



COUNCIL DECISION (CFSP) 2022/241

of 21 February 2022

amending Decision 2014/145/CFSP concerning restrictive measures in respect of actions undermining or threatening the territorial integrity, sovereignty and independence of Ukraine

THE COUNCIL OF THE EUROPEAN UNION,

Having regard to the Treaty on European Union, and in particular Article 29 thereof,

Having regard to the proposal from the High Representative of the Union for Foreign Affairs and Security Policy,

Whereas:

- (1) On 17 March 2014, the Council adopted Decision 2014/145/CFSP ⁽¹⁾.
- (2) The European Union does not recognise and continues to condemn the illegal annexation of Crimea and Sevastopol by the Russian Federation and therefore does not recognise the so-called elections held in the illegally annexed Crimean peninsula.
- (3) Following the organisation, by the Russian Federation, of so-called elections for the State Duma in the illegally annexed 'Autonomous Republic of Crimea' and City of Sevastopol in September 2021, the Council considers that five individuals should be added to the list of persons, entities and bodies subject to restrictive measures set out in the Annex to Decision 2014/145/CFSP for their role in undermining or threatening the territorial integrity, sovereignty and independence of Ukraine.
- (4) The Annex to Decision 2014/145/CFSP should therefore be amended accordingly,

HAS ADOPTED THIS DECISION:

Article 1

The persons listed in the Annex to this Decision shall be added to the list set out in the Annex to Decision 2014/145/CFSP.

*Article 2*This Decision shall enter into force on the date of its publication in the *Official Journal of the European Union*.

Done at Brussels, 21 February 2022.

For the Council
The President
J. BORRELL FONTELLES

⁽¹⁾ Council Decision 2014/145/CFSP of 17 March 2014 concerning restrictive measures in respect of actions undermining or threatening the territorial integrity, sovereignty and independence of Ukraine (OJ L 78, 17.3.2014, p. 16).



ANNEX

The following persons are added to the list of persons, entities and bodies set out in the Annex to Decision 2014/145/CFSP:

Name	Identifying information	Reasons	Date of listing
204. Aleksei Yurievich CHERNIAK (Алексей Юрьевич ЧЕРНЯК)	Gender: Male DOB: 27.8.1973 POB: Alma-Ata, Kazakh SSR (now Kazakhstan) Nationality: Russian	Member of the State Duma of the Russian Federation since 19 September 2021. Elected from the illegally annexed 'Autonomous Republic of Crimea' in the so-called 'Simferopol constituency'. Member of the ruling United Russia party. In taking on and acting in this capacity, he has worked for further integration of the so-called 'Republic of Crimea' into the Russian Federation and thereby actively supported actions and implemented policies which undermine or threaten the territorial integrity, sovereignty and independence of Ukraine.	21.2.2022
205. Leonid Ivanovich BABASHOV (Леонид Иванович БАБАШОВ)	Gender: Male DOB: 31.1.1966 POB: Petrovka, Crimea Oblast, Ukrainian SSR (now Ukraine)	Member of the State Duma of the Russian Federation since 19 September 2021. Elected from the illegally annexed 'Autonomous Republic of Crimea' in the so-called 'Yevpatoria constituency'. Member of the ruling United Russia party. In taking on and acting in this capacity, he has worked for further integration of the so-called 'Republic of Crimea' into the Russian Federation and thereby actively supported actions and implemented policies which undermine or threaten the territorial integrity, sovereignty and independence of Ukraine.	21.2.2022
206. Tatiana Georgievna LOVACH (Татьяна Георгиевна ЛОВАЧ)	Gender: Female DOB: 8.1.1974 POB: Khmelnytskyi, Ukrainian SSR (now Ukraine)	Member of the State Duma of the Russian Federation since 19 September 2021. Elected from the illegally annexed City of Sevastopol in the so-called 'Sevastopol constituency'. Member of the ruling United Russia party. In taking on and acting in this capacity, she has worked for further integration of the illegally annexed City of Sevastopol into the Russian Federation and thereby actively supported actions and implemented policies which undermine or threaten the territorial integrity, sovereignty and independence of Ukraine.	21.2.2022



	Name	Identifying information	Reasons	Date of listing
207.	Nina Sergeevna FAUSTOVA (Нина Сергеевна ФАУСТОВА)	Gender: Female DOB: 11.7.1983 POB: Kyzyl, Republic of Tuva, Russian SFSR (now Russian Federation)	Head of the Sevastopol electoral commission, which took part in the organisation of the so-called elections in the illegally annexed 'Autonomous Republic of Crimea' and City of Sevastopol held in September 2021. In taking on and acting in this capacity, she actively supported and implemented actions and policies which undermine the territorial integrity, sovereignty and independence of Ukraine, and further destabilised Ukraine.	21.2.2022
208.	Aleksandr Evgenievich CHMYHALOV (Александр Евгеньевич ЧМЫХАЛОВ)	Gender: Male DOB: 13.6.1990	Deputy Head of the Sevastopol electoral commission, which took part in the organisation of the so-called elections in the illegally annexed 'Autonomous Republic of Crimea' and City of Sevastopol held in September 2021. Member of the ruling 'United Russia' party. In taking on and acting in this capacity, he actively supported and implemented actions and policies which undermine the territorial integrity, sovereignty and independence of Ukraine, and further destabilised Ukraine.	21.2.2022



VENDIMET

VENDIM I KËSHILLIT (CFSP) 2022/429

më 15 mars 2022

për ndryshimin e Vendimit 2014/145/CFSP në lidhje me masat kufizuese në lidhje me veprimet që cenojnë ose kërcënojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Bashkimin Evropian, dhe në veçanti nenin 29 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit Evropian për Punë të Jashtme

dhe Politikë të Sigurisë, duke pasur parasysh:

- (1) Më 17 mars 2014, Këshilli miratoi Vendimin 2014/145/CFSP⁽¹⁾.
- (2) Bashkimi Evropian mbetet i palëkundur në mbështetjen e tij për sovranitetin dhe integritetin territorial të Ukrainës.
- (3) Më 24 shkurt 2022, Presidenti i Federatës Ruse njoftoi një operacion ushtarak në Ukrainë dhe forcat e armatosura ruse filluan një sulm ndaj Ukrainës. Ai sulm është një shkelje e hapur e integritetit territorial, sovranitetit dhe pavarësisë së Ukrainës.
- (4) Në konkluzionet e tij të 24 shkurtit 2022, Këshilli Evropian dënoi në termat më të ashpër të mundshëm agresionin ushtarak të paprovokuar dhe të pajustificuar të Federatës Ruse kundër Ukrainës. Me veprimet e saj të paligjshme ushtarake, Rusia po shkel rëndë ligjin ndërkombëtar dhe parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara, dhe po minon sigurinë dhe stabilitetin evropian dhe global. Këshilli Evropian ra dakord për masa të mëtejshme kufizuese që do të imponojnë pasoja masive dhe të rënda ndaj Rusisë për veprimet e saj, në koordinim të ngushtë me partnerët dhe aleatët e Bashkimit Evropian.
- (5) Më 25 shkurt 2022, Këshilli miratoi Vendimin (CFSP) 2022/329⁽²⁾, i cili ndryshoi kriteret e përcaktimit për të përfshirë personat dhe subjektet që mbështesin dhe përfitojnë nga Qeveria e Federatës Ruse, personat dhe subjektet që ofrojnë një burim të konsiderueshëm të ardhurash për Qeverinë e Federatës Ruse dhe personat fizikë ose juridikë të lidhur me personat e listuar ose subjektet.
- (6) Në funksion të gravitetit të situatës, Këshilli vlerëson se 15 individë dhe 9 subjekte duhet të shtohen në listën e personave, subjekteve dhe organeve që i nënshtrohen masave kufizuese të përcaktuara në aneksin e Vendimit 2014/145/CFSP.
- (7) Prandaj, Vendimi 2014/145/CFSP duhet të ndryshohet në përputhje me rrethanat,

KA MIRATUAR KËTË VENDIM:

Neni 1

Aneksi i Vendimit 2014/145/CFSP është ndryshuar në përputhje me Aneksin e këtij Vendimi.

- (1) Vendimi i Këshillit 2014/145/CFSP i 17 marsit 2014 në lidhje me masat kufizuese në lidhje me veprimet që cenojnë ose kërcënojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës [OJ L 78, 17.3.2014, f. 16].
- (2) Vendimi i Këshillit (CFSP) 2022/329 i 25 shkurtit 2022 që ndryshon Vendimin 2014/145/CFSP në lidhje me masat kufizuese në lidhje me veprimet që cenojnë ose kërcënojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës [OJ L 50, 25.2.20].



15.3.2022

Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian

L 87 I/45

SHQ

Neni 2

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Bërë në Bruksel, më 15 mars 2022.

Për Këshillin
Presidenti
J.-Y. LE DRIAN



L 87 I/46

SHQ

Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian

15.3.2022

ANEKSI

Personat dhe subjektet e mëposhtme i shtohen listës së personave, enteve dhe organeve të përcaktuara në Aneksin e Vendimit 2014/145/CFSP:

Personat

Emri	Informacion identifikues	Arsye	Data e listimit
'879 Roman Arkadyevich АВРАМОВИЧ (russisht: Роман Аркадьевич Абрамович)	Oligark i afërt me Vladimir Putin. Aksioneri kryesor i Evraz, ish guvernatori i Chukotka. Datëlindja: 24.10.1966 Vendndodhja: Saratov, Federata Ruse Kombësia: Ruse Gjinia mashkull Personat e lidhur: Vladimir Putin Subjektet e lidhura: Chelsea FC, Evraz Group SA, LLC Evraz Holding, Millhouse Capital.	Roman Abramovich është një oligark rus që ka lidhje të gjata dhe të ngushta me Vladimir Putin. Ai ka pasur akses të privilegjuar me presidentin dhe ka mbajtur marrëdhënie shumë të mira me të. Kjo lidhje me liderin rus e ndihmoi atë të ruante pasurinë e tij të konsiderueshme. Ai është një aksioner kryesor i grupit të çelikut Evraz, i cili është një nga taksapaguesit më të mëdhenj të Rusisë. Prandaj ai ka përfutur nga vendimmarrësit rusë përgjegjësi për aneksimin e Krimesë ose destabilizimin e Ukrainës. Ai është gjithashtu një nga biznesmenët kryesorë rusë të përfshirë në sektorët ekonomikë, duke siguruar një burim të konsiderueshëm të ardhurash për Qeverinë e Federatës Ruse, e cila është përgjegjëse për aneksimin e Krimesë dhe destabilizimin e Ukrainës.	15.3.2022
880 German Borisovich KHAN (russisht: Герман Борисович Хан)	Oligark i afërt me Vladimir Putin. Një nga aksionerët kryesorë të Alfa Group DATELINDJA: 24.10.1961 POB: Kiev, Ukrainë Kombësia: Ruse Gjinia mashkull Individët e lidhur: Vladimir Putin, Mikhail Fridman, Petr Aven, Alexey Kuzmichev Subjektet e lidhura: Alfa Group, Alfa Bank	German Khan është një aksioner kryesor i konglomeratit Alfa Group, i cili përfshin Alfa Bank, një nga taksapaguesit më të mëdhenj të Rusisë. Ai besohet të jetë një nga personat më me ndikim në Rusi. Ashtu si pronarët e tjerë të Alfa Bank (Mikhail Fridman dhe Petr Aven), ai mban një marrëdhënie të ngushtë me Vladimir Putin dhe vazhdon të tregtojë favore të rëndësishme me të. Pronarët e Alfa Group marrin përfitime biznesi dhe ligjore nga kjo marrëdhënie. Vajza e madhe e Vladimir Putin, Maria drejtoi një projekt bamirësie, Alfa-Endo, i cili u financua nga Alfa Bank. Vladimir Putin shpërbleu besnikërinë e Alfa Group ndaj autoriteteve ruse duke ofruar ndihmë politike për planet e investimeve të huaja të Alfa Group. Prandaj ai ka mbështetur aktivisht materialisht ose financiarisht dhe ka përfutur nga vendimmarrësit rusë përgjegjësi për aneksimin e Krimesë ose destabilizimin e Ukrainës. Ai është gjithashtu një nga personat kryesorë të biznesit rus të përfshirë në sektorët ekonomikë, duke siguruar një burim të konsiderueshëm të ardhurash për Qeverinë e Federatës Ruse, e cila është përgjegjëse për aneksimin e Krimesë dhe destabilizimin e Ukrainës.	15.3.2022



15.3.2022

SHQ

Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian

L 87 I/47

	Emri	Informacion identifikues	Arsye	Data e listimit
881	Viktor Filippovich RASHNIKOV (russisht: Виктор Филиппович Рашиков)	Oligarku. Pronar, kryetar i Bordit të Drejtorëve dhe kryetar i Komitetit për Planifikimin Strategjik të Punimeve të Hekurit dhe Çelikut Magnitogorsk (MMK). DATELINDJA: 3.10.1948 POB: Magnitorsk, Federata Ruse Kombësia: Ruse Gjinia mashkull Subjektet e lidhura: Magnitogorsk Iron & Steel Works (MMK)	Viktor Rashnikov është një oligark kryesor rus i cili është pronar dhe kryetar i Bordit të Drejtorëve të kompanisë Magnitogorsk Iron & Steel Works (MMK). MMK është një nga taksapaguesit më të mëdhenj të Rusisë. Barra tatimore për kompaninë është rritur së fundmi, duke rezultuar në të ardhura dukshëm më të larta në buxhetin e shtetit rus. Prandaj, ai është një biznesmen kryesor rus i përfshirë në sektorët ekonomikë duke siguruar një burim të konsiderueshëm të ardhurash për Qeverinë e Federatës Ruse, e cila është përgjegjëse për aneksimin e Krimesë dhe destabilizimin e Ukrainës.	15.3.2022
882	Alexey Viktorovich KUZMICHEN (russisht: Алексей Викторович Кузьмичев)	Oligark i afërt me Vladimir Putin. Një nga aksionerët kryesorë të Alfa Group. DATELINDJA: 15.10.1962 POB: Kirov, Federata Ruse Kombësia: Ruse Gjinia mashkull Individët e lidhur: Vladimir Putin, Mikhail Fridman, Petr Aven, German Khan Subjektet e lidhura: Alfa Group, Alfa Bank	Alexey Kuzmichev është një aksioner kryesor i konglomeratit Alfa Group, i cili përfshin Alfa Bank, një nga taksapaguesit më të mëdhenj të Rusisë. Ai besohet të jetë një nga personat më me ndikim në Rusi. Ai ka lidhje të mira me presidentin rus. Vajza e madhe e Vladimir Putin, Maria, drejtoi një projekt bamirësie, Alfa-Endo, i cili u financua nga Alfa Bank. Vladimir Putin shpërbleu besnikërinë e Alfa Group ndaj autoriteteve ruse duke ofruar ndihmë politike për planet e investimeve të huaja të Alfa Group. Prandaj ai ka mbështetur aktivisht materialisht ose financiarisht dhe ka përfutur nga vendimmarrësit rusë përgjegjës për aneksimin e Krimesë ose destabilizimin e Ukrainës. Ai është gjithashtu një biznesmen kryesor rus i përfshirë në sektorët ekonomikë, duke siguruar një burim të konsiderueshëm të ardhurash për Qeverinë e Federatës Ruse, e cila është përgjegjëse për aneksimin e Krimesë dhe destabilizimin e Ukrainës.	15.3.2022
883	Alexander Alexandrovich MIKHEEV (russisht: Александр Александрович Михеев)	CEO i SHA Rosoboronexport DATELINDJA: 18.11.1961 POB: Moskë, Federata Ruse Kombësia: Ruse Gjinia mashkull Personat e lidhur: Sergey Chemezov	Alexander Mikheev është CEO i Rosoboronexport, i vetmi ndërmjetës shtetëror zyrtar i Rusisë për eksportin dhe importin e produkteve, teknologjive dhe shërbimeve ushtarake dhe me përdorim të dyfishtë. Rosoboronexport është një kompani filial i Rostec, një korporatë shtetërore që mbikëqyr kërkimin dhe zhvillimin e teknologjive ushtarake dhe zotëron disa objekte prodhimi që luajnë një rol të rëndësishëm në vendosjen e këtyre teknologjive në veprim në tushën e betejës. Shitja e armëve siguron një burim të rëndësishëm të ardhurash për qeverinë ruse. Ato përdoren gjithashtu për të çuar përpara objektivat ekonomike dhe strategjike të Rusisë. Nga viti 2000 deri në vitin 2020, Rosoboronexport shiti 180 miliardë dollarë armë për klientët e huaj.	15.3.2022



L 87 I/48

SHQ

Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian

15.3.2022

Emri	Informacion identifikues	Arsye	Data e listimit
	Subjektet e lidhura: Rosoboronexport, Rostec, Shërbimi Federal i Bashkëpunimit Ushtarak-Teknik	Prandaj, ai është një biznesmen kryesor i përfshirë në sektorët ekonomikë, duke siguruar një burim të konsiderueshëm të ardhurash për Qeverinë e Federatës Ruse, e cila është përgjegjëse për aneksimin e Krimesë dhe destabilizimin e Ukrainës.	
884 Alexander Nikolaevich SHOKHIN (Rusisht: Александр Николаевич ШОХИН)	President i Unionit Rus të Industrialistëve dhe Sipërmarrësve Zëvendëskryetar i Bordit të Drejtorëve të Mechel PAO Anëtar i Byrosë së Këshillit të Lartë të partisë politike "Rusia e Bashkuar" DATËLINDJA: 25.12.1951 POB: Savinskoye, Rrethi Kirillovsky, Federata Ruse Kombësia: Ruse Gjinia: mashkull	Alexander Nikolaevich Shokhin është presidenti i Unionit Rus të Industrialistëve dhe Sipërmarrësve - një grup lobi, i cili promovon interesat e biznesit në Rusi. Ai është gjithashtu një zëvendës kryetar i Bordit të Drejtorëve të Mechel PAO - një nga kompanitë kryesore ruse të minierave dhe metaleve, e cila gjeneron një burim të ardhurash për Qeverinë e Federatës Ruse. Pas aneksimit të Krimesë nga Rusia, Shokhin shprehu publikisht nevojën për të drejtuar më shumë investime ruse në Krimë në mënyrë që të kapërcejë bllokadën e mundshme ekonomike nga Perëndimi. Me 24 shkurt 2022, Shokhin mori pjesë në një takim të oligarkëve në Kremlin me Vladimir Putin për të diskutuar ndikimin e kursit të veprimit pas sanksioneve perëndimore. Fakti që ai u ftua për të marrë pjesë në atë takim tregon se ai është një anëtar i rrethit të brendshëm të oligarkëve pranë Vladimir Putin dhe se ai po mbështet ose zbaton veprime ose politika që minojnë ose kërcënojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës, si dhe stabilitetin dhe sigurinë në Ukrainë.	15.3.2022
885 Andrey Valerievich RYUMIN (Rusisht: Андрей Валерьевич Рюмин)	Drejtor Ekzekutiv i Rosseti PJSC (dikur, deri në gusht 2014, i njohur si Russian Grids), kryetar i Bordit DATËLINDJA: 12.06.1980 Kombësia: Ruse Gjinia: mashkull	Ai gjithashtu tregon se ai është një nga personat kryesorë të biznesit të përfshirë në sektorët ekonomikë, duke siguruar një burim të konsiderueshëm të ardhurash për Qeverinë e Rusisë, e cila është përgjegjëse për aneksimin e Krimesë dhe destabilizimin e Ukrainës. Andrey Ryumin, drejtori ekzekutiv i Rosseti PJSC, një kompani e kontrolluar nga shteti rus, e cila është një operator i rrjeteve energjetike, ofron shërbime të lidhjes teknologjike, shërbime të transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike në Rusi. Rosseti PJSC ndërtoi "Nënstacionin "Port", i cili siguron tërheqjen hekurudhore të urës së Krimesë dhe ushqen pjesën e ngarkesave të thata të portit detar. Tamen, si dhe autostradat, në veçanti autostradën M25 Novorossiysk-Ngushticën Kerch.	15.3.2022



15.3.2022

SHQ

Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian

L 87 I/49

	Emri	Informacion identifikues	Arsye	Data e listimit
			Më 24 shkurt 2022, Ryumin mori pjesë në një takim të oligarkëve në Kremlin me Vladimir Putin për të diskutuar ndikimin e kursit të veprimit pas sanksioneve perëndimore. Fakti që ai u ftua për të marrë pjesë në atë takim tregon se ai është një anëtar i rrethit të brendshëm të oligarkëve pranë Vladimir Putin dhe se ai po mbështet ose zbaton veprime ose politika që minojnë ose kërcënojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës, si dhe stabilitetin dhe sigurinë në Ukrainë. Ai gjithashtu tregon se ai është një nga personat kryesorë të biznesit të përfshirë në sektorin ekonomik i cili siguron një burim të konsiderueshëm të ardhurash për Qeverinë e Federatës Ruse, e cila është përgjegjëse për aneksimin e Krimesë dhe destabilizimin e Ukrainës.	
886	Armen Sumbatovich GASPARYAN (russisht: Армен Сумбатович ГАСПАРЯН)	Publicist, propagandist, anëtar i bordit të "Russia Today". DATELINDJA: 04.07.1975 POB: Moskë, Federata Ruse Kombësie: Ruse	Armen Gasparian drejton emisionin e tij "Nablyudeny" për median ruse Sputnik dhe një emision radiofonik në "Vesti FM". Ai gjithashtu boton libra dhe audiolibra dhe vepron si ekspert në emisionin radiofonik "polnyi kontakt" ("Kontakti i plotë") i një propagandisti tjetër Vladimir Solovoyov. Gasparian ka propaganduar vazhdimisht narrativa në përputhje me propagandën e Kremlinit. Ai ka përdorur gabime logjike për të shpjeguar çështjet ndërkombëtare, ka mohuar sovranitetin ukrainas mbi Krimesë dhe ka mbrojtur veprimet e Rusisë në ngushticën e Kerçit kur ajo kapi një anije ukrainase. Ai vazhdon të botojë propagandë pro-ruse në lidhje me pushtimin rus të Ukrainës dhe në mënyrë aktive mohon sovranitetin e Ukrainës. Prandaj ai po mbështet në mënyrë aktive veprime ose politika, të cilat minojnë ose kërcënojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës, si dhe stabilitetin dhe sigurinë në Ukrainë.	15.3.2022
887	Artyom / Artem Grigoryevich SHEYNIN (russisht: Артём Григорьевич ШЕЙНИН)	Propagandisti rus dhe prezantuesi i emisionit "Vremya Pokazhet" ("Koha do ta tregojë") në TV Channel One të kontrolluar nga shteti. DATELINDJA: 26.01.1966 POB: Moskë, Federata Ruse	Artyom Sheynin është një propagandues rus dhe prezantues i talk show "Vremya Pokazhet" ("Koha do ta tregojë") në TV Channel One të kontrolluar nga shteti. Ai bëri deklaratë në mbështetje të aneksimit të paligjshëm të Krimesë dhe njoftjes së pavarësisë së të ashtuquajturave Republika Popullore të Donetskut dhe Luganskut. Në transmetimet e tij të drejtpërdrejta, Sheynin promovon urretjen etnike midis ukrainasve dhe rusëve, mohon sovranitetin dhe integritetin territorial të Ukrainës dhe shpif kundër kundërshtarëve të Putinit në Rusi.	15.3.2022



L 87 I/50

SHQ

Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian

15.3.2022

Emri	Informacion identifikues	Arsye	Data e listimit
	Gjinia: mashkull Kombësia: Ruse	Duke folur për 24 shkurt 2022, ditën e agresionit të pajustificuar ushtarak rus në shkallë të plotë kundër Ukrainës, Sheynin deklaroi se operacioni rus në Ukrainë ishte i pashmangshëm dhe qëllimi i tij ishte të detyronte autoritetet ukrainase të ruanin paqen. Prandaj ai po mbështet në mënyrë aktive veprime ose politika, të cilat minojnë ose kërcënojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës, si dhe stabilitetin dhe sigurinë në Ukrainë.	
888 Dmitri Yevgenyevich КУЛИКОВ (russisht: Дмитрий Евгеньевич КУЛИКОВ)	Eksptert i Komitetit të Dumës Shtetërore të RF për Çështjet e CIS dhe Marrëdhëniet me Bashkatdhetarët. Producent filmash, prezantues televiziv dhe radiofonik. Anëtar i Këshillit Publik të Ministrisë së Mbrojtjes së Federatës Ruse DATELINDJA: 18.11.1967 POB: Shakhtyorsk, rajoni Donbas, Ukrainë Kombësia: Ruse Gjinia mashkull	Dmitry Kulkov është një propagandist pro-Kremlin. Ai bëri komente publike në kanalet televizive shtetërore në përputhje me narrativën e Kremlinit për situatën në rajonin e Donbasit. Ai justifikoi gjithashtu veprimet e autoriteteve ruse që kërcënojnë integritetin dhe sovranitetin territorial të Ukrainës, si pezullimi i zbatimit të Marrëveshjeve të Minskut ose vendimi për të njohur "republikat e pavarura të Donbasit dhe Luhanskut". Prandaj ai po mbështet në mënyrë aktive veprime ose politika, të cilat minojnë ose kërcënojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës, si dhe stabilitetin dhe sigurinë në Ukrainë.	15.3.2022
ç) nuk përbën kërcënim për sigurinë kombëtare dhe rendin publik të Republikës së Shqipërisë;

d) nuk figuron i regjistruar si person me rekorde kriminale në listat e organizatave ndërkombëtare partnere të sigurisë;

dh) deklaron se do të banojë në territorin e Republikës së Shqipërisë për një periudhë prej të paktën 3 (tre) muajsh gjatë 5 (pesë) vjetëve nga aprovimi i kërkesës;

e) disponon të ardhura dhe burime financiare të ligjshme, të mjaftueshme për jetesën në Republikën e Shqipërisë;

ë) provon kontributin e veçantë në fushën e arsimit, shkencës dhe sportit, si dhe arritjet e veçanta të tij pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin, shkencën dhe sportin;

f) dëshmon arritjen e rezultateve të larta ndërkombëtare në fushën e arsimit, shkencës dhe sportit, sipas disiplinës përkatëse që përfaqëson pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin, sportin dhe shkencën;

g) nuk është subjekt i masave shtrënguese ndërkombëtare, të pranuara nga Republika e Shqipërisë.

KREU III

KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR FORMËN DHE PARAQITJEN E KËRKESËS PËR FITIMIN E SHTETËSISË SHQIPTARE

1. Kërkesa për fitimin e shtetësisë shqiptare bëhet në bazë të formularëve të kërkesës së miratuar nga Agjencia për Hartimin e Programeve të Veçanta të Shtetësisë (në vijim “AHPVSH”).

2. Dokumentet shoqëruese duhet të jenë në gjuhën shqipe ose të përkthyer me vërtetim noteri.

3. Kërkesa për përfshirjen në programin e veçantë të shtetësisë paraqitet në AHPVSH, në formë elektronike ose nëpërmjet postës, nga vetë kërkuesi ose përfaqësuesi me prokurë.

4. Në çdo rast, kërkesat për fitimin e shtetësisë shqiptare të paraqitura prej përfaqësuesit me prokurë në emër të kërkuesit duhet të nënshkruhen nga vetë kërkuesi në emër të të cilit paraqitet kërkesa.

5. Në rast se rezulton që kërkesa për fitimin e shtetësisë nuk është nënshkruar nga vetë kërkuesi, kjo përbën shkak për mospranimin e saj.

6. Kërkesa për fitimin e shtetësisë shqiptare duhet të përmbajë:

a) emrin, atësinë, mbiemrin, datëlindjen, vendlindjen, vendbanimin ose vendqëndrimin e kërkuesit;

b) tregimin e fakteve dhe të rrethanave, që mbështesin kërkimin për fitimin e shtetësisë.



KREU IV
DOKUMENTET E NEVOJSHME
PËR PARAQITJEN E KËRKESËS
PËR SHTETËSI

1. Për të provuar plotësimin e kritereve, duhen këto dokumente:

a) kërkesë individuale për fitimin e shtetësisë shqiptare drejtuar AHPVSH-së, nënshkruar personalisht nga kërkuuesi, sipas formularit të miratuar të kërkesës;

b) kopje e dokumentit të identifikimit;

c) certifikatë personale e kërkuetit;

ç) Certifikatë familjare e kërkuetit;

d) 3 (tri) fotografi në format dokumenti, të cilat duhet të jenë bërë jo më përpara se 6 (gjashtë) muaj nga data e aplikimit, të marrë në plan me sfond të bardhë, të fokusuar dukshëm e qartë. Fotografia duhet të tregojë personin përballë, me shprehje neutrale dhe sytë të hapur e të dukshëm.

dh) certifikata e gjendjes gjyqësore, e lëshuar sipas legjislacionit në fuqi, e marrë në vendin e origjinës, në vendin ku kërkuuesi ka pasur qëndrim të ligjshëm për gjashtë muajt e fundit, në shtetet e treta, ku ka jetuar jo më pak se 6 (gjashtë) muaj, brenda 3 (tri) vjetëve të fundit;

e) dokumente që vërtetojnë disponimin e mjeteve financiare të mjaftueshme për jetesë, si: garanci bankare, vërtetime zyrtare të ardhurash (fotokopje e noterizuar);

ë) deklaratë se do të banojë në territorin e Republikës së Shqipërisë për një periudhë për të paktën 3 (tre) muaj gjatë 5 (pesë) vjetëve nga aprovimi i kërkesës;

f) dëshmi për arritje të shquara në fushën përkatëse, që kërkuuesi sjell për shtetin shqiptar, vërtetuar nga autoritetet kompetente, shoqëruar me kopje të çmimeve, të vlerësimeve, të titujve të ndryshëm ose çdo dokument tjetër të lëshuar nga autoritetet kompetente të vendit përkatës dhe/ose ndërkombëtar;

g) rekomandime për merita dhe arritje të veçanta në fushën e arsimit, shkencës dhe sportit, sipas disiplinës përkatëse, si më poshtë vijon:

i. 1 (një) rekomandim nga ministria përgjegjëse për arsimin dhe shkencën të vendit të origjinës;

ii. 1 (një) rekomandim nga një institucion përkatës në fushën e arsimit, shkencës dhe sportit të vendit të origjinës;

iii. 2 (dy) rekomandime nga personalitete të fushës së sportit, të vendit të origjinës dhe/ose të shtetit shqiptar, i spikatur në disiplinën përkatëse për të cilën individit kërkon të fitojë shtetësinë shqiptare.

gj) deklaratë se informacionet e dhëna prej tij janë të vërteta dhe të sakta, sipas formularit të kërkesës së miratuar nga AHPVSH-ja;

h) çdo dokument tjetër provues, që vërteton plotësimin e kritereve të parashikuara në kreun II, të këtij vendimi.

2. Dokumentacioni, që i bashkëlidhet kërkesës për fitimin e shtetësisë shqiptare, duhet të jetë origjinal ose në kopje, i njëzuar me origjinalin për ato dokumente për të cilat është i pamundur lëshimi i dokumentit origjinal, për shkak të legjislacionit.

3. Dokumentet origjinale ose, sipas rastit, kopjet e njëzuara të tyre, lëshuar nga organet shtetërore të vendit të origjinës së kërkuetit, duhet të shoqërohen nga vula apostile ose, sipas rastit, nga legalizimi i tyre, bërë nga organet kompetente, sipas legjislacionit në fuqi.

4. Dokumentacioni, bashkëlidhur kërkesës për shtetësi, duhet të jetë lëshuar brenda 6 (gjashtë) muajve të fundit, afat vlefshmërie ky i përllogaritur nga dita e regjistrimit të kërkesës pranë AHPVSH-së.

5. Kërkesat për shtetësi pranohen e përpunohen, me kusht që të jenë paraqitur sipas formës së kërkuar, të përmbajnë gjenealogjet dhe nënshkrimin e kërkuetit, si dhe të shoqërohen me dokumentet e nevojshme e mandatpagesën, sipas tarifave të miratuara.

KREU V
PROCESI I VERIFIKIMIT DHE I
VLERËSIMIT TË KËRKESAVE PËR
SHTETËSI

1. Pas depozitimit të kërkesës dhe të dokumentacionit, AHPVSH-ja, brenda 7 (shtatë) ditëve, bën verifikimin paraprak për plotësimin e kushteve formale të parashikuara në kreun III, të këtij vendimi.

2. Në rast se kërkesa nuk plotëson kushtet e kërkuara formale, AHPVSH-ja ia kthen atë kërkuetit për plotësimin e të metave brenda një afati prej jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditësh.



3. Pasi AHPVSH-ja verifikon paraprakisht se kërkesa i përmbush kushtet formale për paraqitjen e saj, kryen veprimet, si më poshtë vijon:

a) Verifikon nëse kërkuksi plotëson kërkesat teknike, vlefshmërinë dhe ligjshmërinë e dokumentacionit të paraqitur;

b) Kryen verifikimet përkatëse të gjendjes gjyqësore dhe sigurisë kombëtare në mënyrë zyrtare nëpërmjet Shërbimit Informativ të Shtetit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit;

c) I kërkon në mënyrë shkresore ministrisë përgjegjëse për arsimin, shkencën dhe sportin të vlerësojë kontributin e kërkuksit në fushën e arsimit, shkencës dhe sportit, sipas disiplinës që përfaqëson, duke i bashkëlidhur kopje të dëshmive dhe akteve të tjera vlerësuese të arritjeve të depozituara nga kërkuksi, dhe i kërkon, brenda 7 (shtatë) ditëve nga kërkesa për vlerësim kontributi, t'i përcjellë AHPVSH-së në mënyrë zyrtare shkresore vendimin e arsyetuar me të cilin vlerëson se kontributi i kërkuksit përbën interes për shtetin shqiptar.

4. Në rast se ministria përgjegjëse për arsimin, shkencën dhe sportin vlerëson se kontributi i kërkuksit nuk përbën interes në fushën e arsimit, shkencës dhe sportit për Republikën e Shqipërisë, AHPVSH-ja përgatit një relacion informues drejtuar ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike për mosplotësimin e kriterëve teknike nga kërkuksi.

5. Ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike, pas vlerësimit të relacionit dhe konstatimit të mosplotësimit të kriterëve teknike, merr vendim për refuzimin e kërkesës për fitimin e shtetësisë.

6. AHPVSH-ja njofton kërkuksin në adresën e deklaruar në formularin e kërkesës për vendimin e refuzimit të kërkesës për fitimin e shtetësisë shqiptare.

7. Në rast se ministria përgjegjëse për arsimin, shkencën dhe sportin vlerëson se kontributi i shtetasit të huaj përbën interes të veçantë për Republikën e Shqipërisë, AHPVSH-ja vazhdon me procesin e shqyrtimit të kërkesës për fitimin e shtetësisë shqiptare.

8. AHPVSH-ja, pasi shqyrton kërkesën lidhur me përputhshmërinë e kriterëve teknike për fitimin e shtetësisë, vlefshmërinë dhe formën e rregullt ligjore të dokumentacionit, merr konfirmimet zyrtare të verifikimeve të sigurisë dhe pastërtisë së

figurës nga autoritetet kompetente, si dhe vlerësimin pozitiv të kontributit të kërkuksit nga ana e ministrisë përgjegjëse për arsimin, shkencën dhe sportin, përgatit një relacion drejtuar ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike për plotësimin e kushteve të miratuara nga ana e kërkuksit.

KREU VI DISPOZITA TË FUNDIT

Ngarkohen ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike dhe ministri përgjegjës për arsimin, shkencën dhe sportin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletore Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM Nr. 206, datë 6.4.2022

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “PËRFUNDIMI I PUNIMEVE TË MBETURA DHE PLOTËSIMI ME RRUGË DYTËSORE, NYJA E MILOTIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Përfundimi i punimeve të mbetura dhe plotësimi me rrugë dytësore, Nyja e Milotit”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën



bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit “arë”, “truall”, “ndërtesë me funksion banimi” dhe “ndërtesë me funksion socio-ekonomik”, me një vlerë të përgjithshme prej 16 659 775.50 (gjashtëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e pesë pikë pesëdhjetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 16 659 775.50 (gjashtëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e pesë pikë pesëdhjetë) lekësh, përballohet nga buxheti i miratuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga buxheti i miratuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar.

6. Shpronësimi i pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi paraqesin dokumentacionin për likuidim, certifikatën e pronësisë, kartelën e pasurisë, si dhe hartën treguese të regjistrimit pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

8. Autoriteti Rrugor Shqiptar kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, pasqyron në kartelat e pasurive të paluajtshme informacionin për miratimin e shpronësimit dhe marrjen në përdorim të përkohshëm për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, të cilat preken nga realizimi i projektit. Regjistrimi i kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Autoriteti Rrugor Shqiptar, kryhet pas aplikimit nga ARRSH-ja për shërbimin përkatës.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Laç, pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit dhe kalimi i pronësisë në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Laç, si dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Lezhë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NË SEGMENTIN RRUGOR
“PËRFUNDIMI I PUNIMEVE TË MBETURA DHE PLOTËSIMI ME RRUGË DYTËSORE, NYJA E MILOTTI”

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri																
								Sipërfaqja që shpronësohet						Objekti që shpronësohet					Shënime
				Zona	Numri i	Sip.	Lloji i		Tokë “tural”			Tokë “arë”		Banim		Soc.-ek.		Vlera	
				kadastrale	pasurisë	totale	pasurisë	Sipërfaqja	Çmimi	Vlera	Sipërfaqja	Çmimi	Vlera	Sipërfaqja	Vlera	Sipërfaqja	Vlera	totale	
						m ²		e shpr. (m ²)	(lekë/m ²)	lekë	e shpr. (m ²)	(lekë/m ²)	lekë	e shpr. (m ²)	lekë	e shpr. (m ²)	lekë	(lekë)	
1	GJERGJ	NIKOLL	PRENGA	2365	11/1	5760	Arë + tr				169	321	54,249					54,249.00	Certifikuar.
2	PJETER	MARK	HIDRI	2365	11/2	2500	Arë				197	321	63,237					63,237.00	Konf. nga ASHK-ja.
3	GJIN	NIKOLL	BURAKU	2365	2/4	14280	Arë				2,328	321	747,288					747,288.00	Konf. nga ASHK-ja.
4	MARK	PASHK	RICA	2365	1/4	10100	Arë				2,527	321	811,167					811,167.00	Certifikuar.
5	ADRIANA	AVDYL	MARKU	2365	3/3	7200	Arë				2,138	321	686,298					686,298.00	Certifikuar.
	JORGO	MUSA	MARKU																
6	NDUE	PRENG	TUCI	2365	10/18	7500	Arë				1,006	321	322,926					322,926.00	Certifikuar.
7	PREN	NIKOLL	HIDRI	2365	11/20	1250	Arë				79	321	25,359					25,359.00	Urdhër sekuestroje.
8	PRENG	LLESH	GJOKA	2365	9/1	1000	Arë				201	321	64,521					64,521.00	Plotësim dokumentacioni (pa certifikuar).
9	ALEKSANDER	BARDHOK	BIBAJ	2365	9/20	2500	Arë				242	321	77,682					77,682.00	Konf. nga ASHK-ja.
10	BARDHOK, PRENE, ANTON, ALMA		BIBAJ	2365	9/19	6593	Arë				651	321	208,971					208,971.00	Konf. nga ASHK-ja.
11	SHKELZEN	NIKOLL	GJERGJI	2365	9/23	2676.3	Arë				178	321	57,138					57,138.00	Konf. nga ASHK-ja.
12	NDUE	NIKOLL	HIDRI	2365	11/21	1250	Tural + nd.	130	294	38220								38,220.00	Union Bank (certifikuar).
13	BARDHOK	KOL	KOLA	3441	9/1	3360	Arë				161	278	44,758					44,758.00	Plotësim dokumentacioni (pa certifikuar).
14	GJET	NDU	GJETA	3441	9/52	8000	Arë				54	278	15,012					15,012.00	Konf. nga ASHK-ja.
15	RAMIZ	MUHARREM	LAMA	3441	10/9	10172	Arë				1,800	278	500,400					500,400.00	Konf. nga ASHK-ja.
16	SEHIT	RIZA	LAMA	3441	10/20	9072	Arë				377	278	104,806					104,806.00	Plotësim dokumentacioni (pa certifikuar).
17	FILIP	LLESH	KOLA	3441	9/6	1851	Arë				14	278	3,892					3,892.00	Plotësim dokumentacioni (pa certifikuar).
18	FLAMUR	KOL	KOLA	3441	9/2	2012	Arë				21	278	5,838					5,838.00	Plotësim dokumentacioni (pa certifikuar).
19	ZENEL	ALI	ZENELI	3441	9/35	1100	Arë				695	278	193,210					193,210.00	Certifikuar.
20	NDOC	DED	BROZI	3441	9/46	6048	Arë				790	278	219,620					219,620.00	Konf. nga ASHK-ja.
21	NAZMIJE, XHEVAHIR, ADELINA, ERMIRA		LAMA	3441	77/25	3600	Arë				1,120	278	311,360					311,360.00	Konf. nga ASHK-ja.
22	HAJDAR	SALI	LAMA	3441	13/13	9088	Arë				201	278	55,878					55,878.00	Urdhër sekuestro (pa certifikuar).
23	HASAN	FASLLI	LAMA	3441	14/24	8512	Arë				197	278	54,766					54,766.00	Konf. nga ASHK-ja.
24	MURAT	RAMAZAN	LAMA	3441	77/7	12000	Arë				1,366	278	379,748					379,748.00	Plotësim dokumentacioni (pa certifikuar).
25	BESNIK	HAJREDIN	ÇAKONI	3441	22/2	1604	Arë				20	278	5,560					5,560.00	Plotësim dokumentacioni (pa certifikuar).
26	HAMDI	ISLAM	LIKA	3441	9/33	3006	Arë				70	278	19,460					19,460.00	Plotësim dokumentacioni (pa certifikuar).
27	MHILL	NDUE	NDRECA	3441	6/50	5744	Arë + tr.				592	278	164,576					164,576.00	Konf. nga ASHK-ja.
28	ABAZ	HASAN	TAFILI	3441	79/1	17000	Arë				978	278	271,884					271,884.00	Konf. nga ASHK-ja.
29	PAJ	HASAN	TAFILI	3441	8/1	12610	Arë				1,236	278	343,608					343,608.00	Plotësim dokumentacioni (pa certifikuar).
30	PJETER	LEK	LALA	3441	78/5	7000	Arë				1,021	278	283,838					283,838.00	Plotësim dokumentacioni (pa certifikuar).
31	GJERGJ	MARK	SEFGJINI	3441	76/4	17430	Arë + tr.				2,684	278	746,152					746,152.00	Konf. nga ASHK-ja.



32	MARK	NDUE	BARDHI	3441	70/19	15180	Arë + tr.				728	278	202,384				202,384.00	Konf. nga ASHK-ja.
33	BASHKËPRONARËT BROZI GJEÇAJ LLESHAJ			3441	9/43	715	Arë + tr.				72	278	20,016				20,016.00	Konf. nga ASHK-ja.
34	DRITAN	PRENG	GJETA	3441	9/56	8000	Arë				1,219	278	338,882				338,882.00	Konf. nga ASHK-ja.
	ADELINA	PRENG	GJETA															
35	ZAN	IBRAHIM	LIKA	3441	9/34	4008	Arë				85	278	23,630				23,630.00	Plotësim dokumentacioni (pa certifikuar).
36	KASEM	FASLLI	LAMA	3441	9/29	4008	Arë				100	278	27,800				27,800.00	Konf. nga ASHK-ja.
37	ZEF	NDU	NDRECA	3441	6/41	1489	Arë				243	278	67,554				67,554.00	Konf. nga ASHK-ja.
38	NDUE	MARK	GJOKA	3441	5/7/1	4730	Arë				478	278	132,884				132,884.00	Konf. nga ASHK-ja.
39	ZEF	GJET	BROZI	3441	9/48	3871	Arë + tr.				111	278	30,858				30,858.00	Plotësim dokumentacioni (pa certifikuar).
40	GJOVALIN	ZEF	BROZI	3441	9/49	2940	Arë				74	278	20,572				20,572.00	Konf. nga ASHK-ja.
41	MARK	PRENG	SHEBJA	3441	6/26	6930	Arë				195	278	54,210				54,210.00	Plotësim dokumentacioni (pa certifikuar).
42	RAM	RESHIT	ISUFI	3441	5/12	3680	Arë				184	278	51,152				51,152.00	Plotësim dokumentacioni (pa certifikuar).
43	RAMAZAN	SHAQIR	ISUFI	3441	5/13	3969	Arë				193	278	53,654				53,654.00	Plotësim dokumentacioni (pa certifikuar).
44	SINON	BAFTIAR	ISUFI	3441	5/14	5460	Arë				275	278	76,450				76,450.00	Plotësim dokumentacioni (pa certifikuar).
45	HUME	AHMET	KUQI	1677	22/32	1982	Arë				569	291	165,579				165,579.00	Plotësim dokumentacioni (pa certifikuar).
46	PASHK	BARDHOK	KOLA	1677	22/37	3612	Arë				245	291	71,295				71,295.00	Konf. nga ASHK-ja.
47	ALTIN	GJON	BIBA	1677	28/62	1500	Arë				18	291	5,238				5,238.00	Konf. nga ASHK-ja.
	ANDUELA	MIHAL	BIBA															
48	ÇALOK	SUL	KASMI	1677	26/34	3000	Arë				71	291	20,661				20,661.00	Plotësim dokumentacioni (pa certifikuar).
49	MARSDA	HAKI	ZENELI	1677	26/30	2902	Arë				1,283	291	373,353				373,353.00	Konf. nga ASHK-ja.
50	PRENG	PJETER	BIBA	1677	29/1	8960	Arë				599	291	174,309				174,309.00	Plotësim dokumentacioni (pa certifikuar).
51	FRROK	PRENG	BIBA	1677	29/2	8960	Arë				175	291	50,925				50,925.00	Plotësim dokumentacioni (pa certifikuar).
52	MARJAN	GJON	BIBA	1677	29/30	8136	Arë				525	291	152,775				152,775.00	Konf. nga ASHK-ja.
53	BEG	PAJ	HAXHIU	1677	28/43	4758	Arë				505	291	146,955				146,955.00	Konf. nga ASHK-ja.
54	NEZIR	DERVISH	HALILI	1677	24/22	4800	Arë				614	291	178,674				178,674.00	Plotësim dokumentacioni (pa certifikuar).
55	HASAN	KURT	KASMI	1677	3/41	7400	Arë				278	291	80,898				80,898.00	Plotësim dokumentacioni (pa certifikuar).
56	ABAZ	AHMET	MURATI	1677	2/7	6700	Arë				154	291	44,814				44,814.00	Plotësim dokumentacioni (pa certifikuar).
57	ISMAIL	XHEMAL	KASMI	1677	2/16	10730	Arë				550	291	160,050				160,050.00	Konf. nga ASHK-ja.
58	JETMIR	PAL	KOLAJ	1677	27/69	3564	Arë + tr.+ nd.	53	295	15635	337	291	98,067		388.02	3,511,676.64	3,625,378.64	Konf. nga ASHK-ja.
59	FRROK	VORF	PALAJ	1677	28/65	8700	Arë				287	291	83,517				83,517.00	Konf. nga ASHK-ja.
60	BAJRAM	SHABAN	HYSENI	1677	5/19	1724	Arë				230	291	66,930				66,930.00	Konf. nga ASHK-ja.
61	XHAFFERR	HASAN	LAMA	1677	4/33	1904	Arë				462	291	134,442				134,442.00	Konf. nga ASHK-ja.
62	GANI	ALI	LAMA	1677	4/31	2008	Arë				167	291	48,597				48,597.00	Plotësim dokumentacioni (pa certifikuar).
63	MARTINAJ E.M			1677	28/16	4000	Arë				172	291	50,052				50,052.00	Konf. nga ASHK-ja.
64	NIKOLL	DED	BRUKA	1677	6/30	10266	Arë + tr.				965	291	280,815				280,815.00	Certifikuar.
	DRANE	FRROK	BRUKA															
65	AHMET	VESEL	LAMA	1677	3/20	3100	Arë				232	291	67,512				67,512.00	Plotësim dokumentacioni (pa certifikuar).
66	MARJAN	GJON	BIBA	1677	29/55	1650	Arë				118	291	34,338				34,338.00	Konf. nga ASHK-ja.
67	LLESH	GJERGJ	GEGA	1677	23/26	8050	Arë				500	291	145,500				145,500.00	Plotësim dokumentacioni (pa certifikuar).
68	ERVIN	SKENDER	KASMI	1677	25/40	3937	Arë				31	291	9,021				9,021.00	Konf. nga ASHK-ja.
	LULZIME	XHEMAL	KASMI															



69	HYSEN	HASAN	KASMI	1677	7/18/1	200	Truall + nd.	72	295	21240				52.8	1,430,855			1,452,094.86	Shpronësohet për 52.8 m ² sipas objektit faktik në terren (pa certifikuar).
70	GJET	LLESH	LLESHI	1677	28/59	1540	Arë				147	291	42,777					42,777.00	Konf. nga ASHK-ja.
71	MARTINAJ E.M			1677	29/48	2202	Arë + tr. + nd.				420	291	122,220					122,220.00	Konf. nga ASHK-ja.
72	SABA	SUL	KASMI	1677	8/25	3240	Arë				588	291	171,108					171,108.00	Plotësim dokumentacioni (pa certifikuar).
73	AHMET	VESEL	LAMA	1677	4/29	2116	Arë				297	291	86,427					86,427.00	Plotësim dokumentacioni (pa certifikuar).
74	FATMIR	NDUE	GJOKA	1677	29/67	1898	Arë				242	291	70,422					70,422.00	Konf. nga ASHK-ja.
	KLONDINA	ZEF	GJOKA																
75	SHAQIR	BAFTIAR	SULA	1677	5/39	5105	Arë+ tr.				389	291	113,199					113,199.00	Konf. nga ASHK-ja.
76	FATBARDH	SHAQIR	SULA	1677	5/41	4862	Arë				381	291	110,871					110,871.00	Konf. nga ASHK-ja.
77	LEK	NDREC	BIBAJ	1677	10/31	6620	Arë				230	291	66,930					66,930.00	Konf. nga ASHK-ja.
78	BARDHOK	DED	BIBAJ	1677	11/32	2630	Arë				336	291	97,776					97,776.00	Plotësim dokumentacioni (pa certifikuar).
79	TAHIR	SEFER	KASMI	1677	27/58	1040	Arë				183	291	53,253					53,253.00	Konf. nga ASHK-ja.
80	PREN	FRROK	PALAJ	1677	28/67	7925	Arë				188	291	54,708					54,708.00	Konf. nga ASHK-ja.
81	NIKOLL	PJETER	SHQALSI	1677	6/1	1000	Arë				223	291	64,893					64,893.00	Plotësim dokumentacioni (pa certifikuar).
Shuma totale								255.00		75,095.00	39,781.00		11,642,149.00	52.80	1,430,854.86	388.02	3,511,676.64	16,659,775.50	

Shënime.

1. Për pasuritë e llojit “truall” dhe “arë” vlerësimi është kryer bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.

2. Për pasuritë e llojit “ndërtesë me funksion banimi dhe jobanim”, vlerësimi është kryer sipas VKM-së nr. 138, datë 23.3.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar.



VENDIM
Nr. 208, datë 6.4.2022

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE
DHE TË PROCEDURËS PËR
PËRFITIMIN E MBROJTJES SË
VEÇANTË TË GARANTUAR NGA
SHTETI PËR PËRKTHYESIT ZYRTARË
DHE INTERPRETËT E GJUHËS SË
SHENJAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 27, të ligjit nr. 82/2021, “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ky vendim ka për objekt përcaktimin e rregullave të hollësishme për kriteret dhe procedurën e përfitimit të mbrojtjes së veçantë nga shteti për përkthyesit zyrtarë dhe interpretët e gjuhës së shenjave, kur u rrezikohet jeta, familja ose prona gjatë ushtrimit të detyrës ose për shkak të saj.

2. Me mbrojtje të veçantë të jetës, të familjes dhe të pronës, sipas këtij vendimi, kuptohen masat operacionale, që merren për sigurimin e ruajtjen e veçantë fizike, mbrojtjen e familjes dhe të pronës së përkthyesit e interpretit, si dhe masat e tjera, që lidhen me këtë mbrojtje.

3. Kriteret për të përfutuar mbrojtje të veçantë nga shteti janë:

a) prania e rrethanave serioze, që rrezikojnë jetën, familjen ose pronën e përkthyesit apo të interpretit; dhe

b) lidhja shkakësore ndërmjet rrethanave serioze, që rrezikojnë jetën, familjen ose pronën e përkthyesit apo të interpretit të gjuhës së shenjave dhe detyrave, që ushtron përkthyesi ose interpreti.

4. Subjektet që mund të paraqesin kërkesë me shkrim për mbrojtjen e veçantë të përkthyesit/interpretit pranë Komisionit për Mbrojtjen e Përkthyesve Zyrtarë janë:

a) përkthyesi/interpreti, që kërkon mbrojtjen e veçantë;

b) drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit;

c) ministri i Drejtësisë;

ç) çdo organ tjetër publik, që, për shkak të funksionit, merr dijeni për praninë e rrethanave

serioze, që rrezikojnë jetën, familjen ose pronën e përkthyesit/interpretit.

5. Kërkesa paraqitet vetëm kur ka të dhëna të besueshme, të cilat provojnë rrethanat serioze, që vënë në rrezik jetën, familjen ose pronën e përkthyesit/interpretit, për shkak të detyrës ose gjatë ushtrimit të saj.

6. Kërkesa për mbrojtje të veçantë për përkthyesin apo interpretin përmban:

a) gjenealogjetet e kërkuarit të mbrojtjes së veçantë për përkthyesin apo interpretin;

b) gjenealogjetet e përkthyesit apo të interpretit për të cilin kërkohet mbrojtja e veçantë;

c) një përmbledhje të fakteve e të rrethanave, që përbëjnë rrezik serioz për përkthyesin apo interpretin, të cilat detyrojnë sigurimin e mbrojtjes së veçantë, si dhe të provave të mundshme, ku bazohen ato;

ç) burimin e provave se ku bazohen;

d) llojin e masave që kërkohen dhe kohëzgjatjen e tyre.

7. Kur rreziku ndaj përkthyesit apo interpretit është serioz dhe i çastit, drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit urdhëron strukturat e Policisë së Shtetit të marrin masa të menjëhershme për të garantuar mbrojtjen e jetës, të shëndetit të tij apo të familjes ose të pronës, deri në mbledhjen e Komisionit për Mbrojtjen e Përkthyesve Zyrtarë. Komisioni për Mbrojtjen e Përkthyesve Zyrtarë, pas shqyrtimit të kërkesës, vlerëson masat e marra nga strukturat e Policisë së Shtetit dhe vendos, kur është rasti, për vazhdimin e mëtejshëm të tyre ose ndërprerjen e mbrojtjes së veçantë.

8. Kërkesat për mbrojtje të veçantë nga shteti shqyrtohen nga Komisioni për Mbrojtjen e Përkthyesve Zyrtarë (në vijim “komisioni”), i cili ngrihet dhe funksionon pranë Ministrisë së Drejtësisë, me këtë përbërje:

a) 1 (një) përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, i caktuar me urdhër nga ministri i Drejtësisë, i cili është njëkohësisht edhe kryetar i Komisionit;

b) 1 (një) përfaqësues nga radhët e përkthyesve zyrtarë apo interpretëve, sipas rastit, me jo më pak se 5 (pesë) vjet punë si përkthyes zyrtar/interpret, i certifikuar sipas ligjit për përkthimin zyrtar, i zgjedhur nga ministri i Drejtësisë;

c) 1 (një) përfaqësues i Ministrisë së Brendshme, i caktuar me urdhër nga ministri i Brendshëm;



ç) 1 (një) përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, i cili caktohet me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm.

9. Anëtarët e komisionit zgjidhen për një mandat dyvjeçar, pa të drejtë rizgjedhjeje të menjëhershme.

10. Zgjedhja e anëtarit sipas shkronjës “b”, të pikës 8, të këtij vendimi, duhet të synojë, në çdo rast, shmangien e konfliktit të interesit.

11. Anëtarët e komisionit duhet të jenë të pavarur e të paanshëm në vendimmarrjen e tyre për përfitimin e mbrojtjes së veçantë për përkthyesin apo interpretin.

12. Kryetari i komisionit ushtron këto funksione:

a) përgatit, thërret e drejton mbledhjet e komisionit;

b) përfaqëson komisionin në marrëdhëniet me të tretët;

c) siguron mbështetjen administrative dhe organizative për funksionimin e Komisionit;

ç) siguron dokumentimin e mbledhjes së komisionit dhe mbajtjen e dokumentacionit, në përputhje me legjislacionin për arkivat;

d) ushtron çdo detyrë tjetër të caktuar nga legjislacioni në fuqi.

13. Kryetari, menjëherë pas marrjes së kërkesës për mbrojtje të veçantë, njofton anëtarët e komisionit për mbledhjen e radhës. Komisioni duhet të mbledhet menjëherë dhe jo më vonë se 48 (dyzet e tetë) orë nga paraqitja e kërkesës për mbrojtje të veçantë.

14. Mbledhjet e komisionit janë të vlefshme kur janë të pranishëm jo më pak se 3 (tre) anëtarë të tij.

15. Vendimet janë të vlefshme kur miratohen të paktën nga shumica e anëtarëve të pranishëm në mbledhje. Kur votat ndahen në mënyrë të barabartë, vota e kryetarit është përcaktuese.

16. Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë vendim, zbatohen, për aq sa gjejnë zbatim, dispozitat e ligjit për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe të enteve publike.

17. Ministria e Drejtësisë siguron mbështetjen e nevojshme organizative dhe administrative për realizimin e funksionit dhe të detyrave të komisionit. Kryetari i komisionit, në bashkëpunim me sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë, cakton një sekretar nga nëpunësit e strukturës përgjegjëse për veprimtarinë e përkthimit

zyrtar në Ministrinë e Drejtësisë, i cili mban procesverbalin e zhvillimit të mbledhjes.

18. Pjesëmarrja në mbledhjet e komisionit është e detyrueshme. Në rastet kur një anëtar i komisionit nuk merr pjesë në 3 (tri) mbledhje të njëpasnjëshme, pa një shkak të ligjshëm, konsiderohet që ka hequr dorë si anëtar i komisionit. Në këtë rast, kryetari, ose në rastin kur kryetari nuk merr pjesë në 3 (tri) mbledhje të njëpasnjëshme, anëtari i zgjedhur nga radhët e përkthyesve/interpretëve, njofton menjëherë organin e emërtesës dhe Ministrinë e Drejtësisë.

19. Komisioni, gjatë procesit të shqyrtimit të kërkesave për mbrojtje të veçantë të përkthyesit apo të interpretit, të familjes e të pronës së tij, mund të kërkojë informacione nga institucione të tjera. Institucionet publike janë të detyruara të përmbushin kërkesat e komisionit për informacion, me përjashtim të rasteve të kufizuara me ligj, brenda afatit të përcaktuar nga komisioni në kërkesën e tyre.

20. Komisioni merr në shqyrtim kërkesën e paraqitur dhe, kur bindet në bazë të fakteve dhe të rrethanave, që çojnë në dyshimin e arsyeshëm për nevojën e sigurimit të mbrojtjes për përkthyesit dhe interpretët e gjuhës së shenjave, miraton me vendim mbrojtjen e veçantë. Vendimi përmban masat konkrete të mbrojtjes së veçantë, numrin e shoqëruesve personalë, kur është rasti, afatin, brenda të cilit sigurohet mbrojtja, si dhe masa të tjera, që lidhen me këtë mbrojtje.

21. Komisioni zbaton, për aq sa është e mundur, rregullat e Kodit të Procedurave Administrative për shqyrtimin e kërkesave për mbrojtjen e veçantë të përkthyesit apo të interpretit.

22. Vendimi i komisionit u njoftohet përkthyesit apo interpretit, sipas rastit, nga Ministria e Drejtësisë, dhe strukturave përgjegjëse për mbrojtjen nga përfaqësuesi i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

23. Komisioni, me kërkesë të subjekteve të përcaktuara në pikën 4, të këtij vendimi, kur ka të dhëna të besueshme, që provojnë se përkthyesit apo interpretit të gjuhës së shenjave i rrezikohet jeta, familja ose prona, mund të vendosë zgjatjen e afatit të masave të mbrojtjes, nëse rrethanat, për të cilat është siguruar më parë mbrojtja, vazhdojnë të ekzistojnë edhe pas përfundimit të këtij afati.



24. Në rast se rreziku ndaj jetës, familjes ose pronës së përkthyesit apo të interpretit të shenjave nën mbrojtje pushon së ekzistuari përpara përfundimit të afatit të mbrojtjes, sipas përcaktimit në vendimin e komisionit, me kërkesën e çdo subjekti të përcaktuar në pikën 4, të këtij vendimi, komisioni mund të vendosë të ndërpresë mbrojtjen e veçantë.

25. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 211, datë 6.4.2022

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES
NDRYSHUESE ME SHKËMBIM
NOTASH TË MARRËVESHJES SË
GRANTIT NDËRMJET MINISTRISË SË
SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES
SOCIALE, NË EMËR TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË, DHE FONDIT GLOBAL
PËR TË LUFTUAR SIDA-n,
TUBERKULOZIN DHE MALARIEN,
PËR PROGRAMIN “PËRSHKALLËZIMI
DHE SIGURIMI I QËNDRUESHMËRISË
SË PËRGJIGJES KOMBËTARE NDAJ
HIV/SIDA-s DHE TUBERKULOZIT, NË
GRUPET KRYESORE TË
POPULLATËS”, MIRATUAR ME
VENDIMIN NR. 219, DATË 12.3.2020, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim notash të marrëveshjes së grantit ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes

Faqe| 7672

Sociale, në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, dhe Fondit Global për të Luftuar SIDA-n, Tuberkulozin dhe Malarien, për programin “Përshkallëzimi dhe sigurimi i qëndrueshmërisë së përgjigjes kombëtare ndaj HIV/SIDA-s dhe tuberkulozit në grupet kryesore të popullatës”, miratuar me vendimin nr. 219, datë 12.3.2020, të Këshillit të Ministrave, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Ref: EECA/DF/292-14/10/2021
14 tetor 2021

Znj. Ogerta Manastirliu
Ministër
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale e Republikës së Shqipërisë
Rruga e Kavajës, nr. 1001
Tiranë – Shqipëri

Lënda: Granti: ALB-C-MOH
Përfituesi kryesor: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale e Republikës së Shqipërisë
Letër Zbatimi Numër: 4¹
Rishikimi i Grantit

E nderuar znj. Manastirliu,
Në referencë të Konfirmimit të Grantit të datës 21 shkurt 2020 (i ndryshuar herë pas here, “**Konfirmimi i Grantit**”) ndërmjet Fondit Global për Luftën kundër SIDA-s, Tuberkulozit dhe Malaries. (“**Fondi Global**”) dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale e Republikës së Shqipërisë (“**Përfituesi Kryesor**”), në emër të Republikës së Shqipërisë (“**Përfituesi i Grantit**”) për grantin ALB-C-MOH (“**Granti**”). Me përjashtim të rasteve, kur përkufizohet në këtë Letër Zbatimi ose konteksti e kërkon ndryshe, të gjitha përkufizimet me shkronja të madha të përdorura në këtë Letër Zbatimi kanë kuptimin e përcaktuar në Konfirmimin e Grantit.

¹ Konfirmimi i Grantit është modifikuar më parë nga Letra e Zbatimit nr. 1, e datës 23 shtator 2020; Letra e Zbatimit nr. 2, datë 3 dhjetor 2020 dhe Letra e Zbatimit nr. 3, datë 15 qershor 2021.



Fondi Global ka miratuar fonde shtesë për COVID-19. Si rezultat, kjo letër rrit Fondet e Grantit për Periudhën e Zbatimit me 819,056 USD dhe, gjithashtu, ndryshon Buxhetin Përmbledhës të përfshirë në shtojcën I (Përshkrimi i Grantit të Integruar) të Konfirmimit të Grantit.

Prandaj, ne propozojmë të bëjmë ndryshimet e mëposhtme në Konfirmimin e Grantit:

1. Tabela në seksionin 3 të Konfirmimit të Grantit do të fshihet dhe do të zëvendësohet me tabelën e rishikuar që i bashkëngjitet kësaj letre.

2. Buxheti Përmbledhës do të fshihet dhe do të zëvendësohet me Buxhetin Përmbledhës të rishikuar që i bashkëngjitet kësaj letre.

3. Kërkesat e mëposhtme do të përfshihen në seksionin 6 të Konfirmimit të Grantit:

6.8 Buxheti i Programit përfshin 976,553 USD financim i dhënë, sipas Mekanizmit të Reagimit ndaj COVID-19 të Fondit Global (“Fondet C19RM”) të programuara për aktivitete për t’u përgjigjur pandemisë COVID-19 (“Aktivitetet e Miratuara C19RM”). Pavarësisht çdo kundërshtimi në Marrëveshjen e Grantit, Fondet C19RM duhet të investohen në Aktivitetet e Miratuara të C19RM dhe mund të riprogramohen ose barten në një Periudhë Zbatimi të mëpashtme, vetëm pas miratimit paraprak me shkrim nga Fondi Global, me kusht që Fondet C19RM të mos përdoren pas 31 dhjetorit 2023, përveç rasteve kur është rënë dakord ndryshe, me shkrim nga Fondi Global.

6.9 C19RM Raportimi i Produkteve Shëndetësore

a) Përfituesi Kryesor do t’u përmbahet marrëveshjeve të prokurimit, sipas Modelit të Menaxhimit të Produkteve Shëndetësore C19RM të miratuar nga Fondi Global për Marrëveshjen e Grantit dhe nuk do të bëjë asnjë ndryshim në këto marrëveshje pa miratimin paraprak me shkrim të Fondit Global.

b) Përfituesi Kryesor, deri në datën përkatëse të raportimit të prokurimit (“Data e Raportimit të Progresit të Prokurimit C19RM”), do të plotësojë dhe do të dorëzojë sipas kërkesave të Fondit Global, Modelin e Raportimit të Progresit të Prokurimit C19RM që përcakton: i. datën e lëshimit të urdhër blerjes; ii. datën e dorëzimit të premtuar nga shitësi; iii. datën e dërgimit të produktit nga prodhuesi; dhe iv. datën e dorëzimit të secilit produkt:

i. Produkti Strategjik Shëndetësor C19RM dhe Produkti Kryesor Shëndetësor i prokuruar jashtë Mekanizmit të Prokurimit të Fondit Global (“PPM”); dhe

ii. Produkte të Këshilluara për Burime Lokale C19RM me Raportim të Përforcuar, pasi këta terma përcaktohen në Udhëzimet e Fondit Global C19RM (siç edhe mund të ndryshohen herë pas here dhe t’i njoftohen Përfituesit Kryesor me shkrim).

Data e Raportimit të Progresit të Prokurimit C19RM për këto produkte të prokuruarat përmes kanaleve kombëtare është jo më vonë se 10 janari pas përfundimit të çdo viti kalendarik të Periudhës së Zbatimit.

Data e Raportimit të Progresit të Prokurimit C19RM për këto produkte të prokuruarat përmes kanaleve të prokurimit jo-PPM është jo më vonë se datat e tremujorëve vijues të secilit vit kalendarik i Periudhës së Zbatimit: respektivisht 10 janar, 10 prill, 10 korrik dhe 10 tetor, me datën përfundimtare të Raportimit të Progresit të Prokurimit C19RM që është data përkatëse tremujore dhe që i takon menjëherë pas datës së përfundimit të Periudhës së Zbatimit.

c) Përfituesi Kryesor do të ndërmarrë të gjitha veprimet e duhura dhe të nevojshme për të siguruar që çdo nënmarrës, furnizues, kontraktor ose agjent t’i japë Përfituesit Kryesor informacionin që mund t’i kërkohej që ky i fundit të përmbushë detyrimet e tij të përcaktuara në paragrafin “b” më sipër.

Përveç ndryshimeve të kërkuara nga kjo letër, të gjitha dispozitat e Marrëveshjes së Grantit mbeten të njëjta.

Ju lutemi konfirmoni pajtimin tuaj me ndryshimet e shprehura këtu duke nënshkruar këtë letër dhe duke i kthyer një kopje Fondit Global përmes sistemit të mesazheve elektronike. Këto ndryshime do të hyjnë në fuqi me nënshkrimin e kësaj letre nga një përfaqësues i autorizuar i Menaxhimit Financiar të Grantit të Fondit Global dhe një kopje elektronike e kësaj letre do t’ju dërgohet për arkivin tuaj.

Faleminderit për përpjekjet tuaja të rëndësishme në luftën globale kundër HIV, AIDS-it dhe tuberkulozit. Presim me padurim zbatimin e suksesshëm të Programit.



Singerisht i Juaji

Dumitru Laticevsch
Drejtues Rajonal
Ekipi i Evropës Lindore dhe Azisë Qendrore
Departamenti i Menaxhimit të Granteve

U ra dakord dhe u nënshkrua:

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale e Republikës së Shqipërisë në emër të Republikës së Shqipërisë

Nga: _____

Emri: Ogerta Manastirliu

Titulli: Ministër, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale e Republikës së Shqipërisë

Datë: _____

Bashkëlidhur: Shtojca 1 – Tabela e Rishikuar e Konfirmimit të Grantit

Shtojca II – Buxheti Përmbledhës i Rishikuar për Grantin

Cc: Manjola Kola, Administrator Assistant, CCM Albania

Annie Gjollma, Agjent i Fondit Lokal, Drejtues i Ekipit, PwC

Nënshkruar nga Menaxheri i Financës së Grantit, Departamenti i Menaxhimit të Financave të Granteve për njohjen e kësaj marrëveshjeje nga Fondi Global.

Shevone Corbin

Menaxher Financiar i Grantit,
PST

Datë: _____

SHTOJCA 1

TABELA E RISHIKUAR E KONFIRMIMIT TË GRANTIT

3.1	Vendi ose rajoni pritës:	Republika e Shqipërisë
3.2	Komponenti i sëmundjes:	HIV/AIDS, Tuberkulozi
3.3	Titulli i programit:	Rritja dhe siguri i qëndrueshmërisë së reagimit kombëtar ndaj HIV/AIDS dhe TB ndërmjet popullsisë kryesore
3.4	Emri i Grantit:	ALB-C-MOH
3.5	Numri GA:	1854
3.6	Fondet e Grantit:	Deri në shumën 1,814,737.44 USD ose ekuivalentin e saj në monedha të tjera
3.7	Periudha e Zbatimit:	Nga 1 janari 2020 deri më 31 dhjetor 2022 (përfshirë)
3.8	Përfituesi kryesor:	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale e Republikës së Shqipërisë Rruga e Kavajës, nr. 1001 Tirana Republika e Shqipërisë Në vëmendje të: Znj. Ogerta Manastirliu Ministër, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale e Republikës së Shqipërisë Telefon: +35542362937 Faksimile: Email: ogerta.manastirliu@shendetesia.gov.al
3.9	Viti fiskal:	1 janar deri më 31 dhjetor
3.10	Agjenti i Fondeve Lokale:	PricewaterhouseCoopers, Albania Blvd. Dëshmorët e Kombit Twin Towers Tower 1, 10 th Floor, Tiranë Republika e Shqipërisë Në vëmendje të: Znj. Annie Gjollma Telefon: +41587929100 Faksimile: Email: annie.gjollma@pwc.com
3.11	Kontakti i Fondit Global:	Fondi Global për Luftën kundër SIDA-s, Tuberkulozit dhe Malaries Kampusi Global i Shëndetit Chemin du Pommier 40 1218 Grand-Saconnex, Geneva, Switzerland Në vëmendje të: Dumitru Laticevsch Menaxher Rajonal Divizioni i Menaxhimit të Granteve Telefon: +41 58 791 1700 Faksimile: +41 44 580 6820 Email: dumitru.laticevsch@theglobalfund.org



SHTOJCA 2

BUXHETI PËRMBLEDHËS I RISHIKUAR PËR GRANTIN
(vijon teksti i Buxhetit Përmbledhës të rishikuar)

Përmbledhje e Buxhetit

Shteti	Shqipëri																
Emri i Grantit	ALB-C-MOH																
Periudha e Zbatimit	01-janar-2020 - 31-dhjetor-2022																
Përfutësi Kryesor	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale e Republikës së Shqipërisë																
Sipas Modullit	01/01/2020 - 31/03/2020	01/04/2020 - 30/06/2020	01/07/2020 - 30/09/2020	01/10/2020 - 31/12/2020	Totali Y1	01/01/2021 - 31/03/2021	01/04/2021 - 30/06/2021	01/07/2021 - 30/09/2021	01/10/2021 - 31/12/2021	Totali Y2	01/01/2022 - 31/03/2022	01/04/2022 - 30/06/2022	01/07/2022 - 30/09/2022	01/10/2022 - 31/12/2022	Totali Y3	Totali i Grantit	% e Totalit të Grantit
Programe gjithëpërfshirëse parandaluese për MSM		\$12,120	\$15,958	\$15,958	\$44,035	\$13,752	\$13,752	\$13,752	\$13,752	\$55,010	\$10,392	\$10,392	\$10,392	\$10,392	\$41,570	\$140,615	5.4 %
Programe gjithëpërfshirëse parandaluese për njerëzit që injektojnë drogë (PWID) dhe partnerët e tyre	\$18,750	\$54,210	\$62,453	\$62,453	\$197,866	\$49,899	\$49,899	\$67,241	\$49,899	\$216,939	\$42,843	\$56,673	\$41,087	\$41,087	\$181,691	\$596,497	22.9 %
Programe gjithëpërfshirëse parandaluese për punonjësit e seksit dhe klientët e tyre		\$4,605	\$3,813	\$5,347	\$13,765	\$4,355	\$4,355	\$4,355	\$4,355	\$17,421	\$3,193	\$3,193	\$3,193	\$3,193	\$12,772	\$43,959	1.7 %
Programe gjithëpërfshirëse për njerëzit në burgje dhe mijedise të tjera të mbyllura			\$2,875	\$1,119	\$3,994	\$2,539	\$783	\$783	\$783	\$4,889	\$560	\$560	\$560	\$560	\$2,238	\$11,121	0.4 %
COVID-19		\$80,400		\$106,428	\$186,828	\$51,015				\$51,015	\$435,742	\$257,734	\$121,540	\$4,040	\$819,056	\$1,056,898	40.5 %
PMTCT						\$4,500	\$20,510	\$4,500	\$4,500	\$34,010						\$34,010	1.3 %
Menaxhimi i Programit	\$20,876	\$20,876	\$31,316	\$26,182	\$99,249	\$38,276	\$20,876	\$20,876	\$26,182	\$106,209	\$38,276	\$20,876	\$20,876	\$26,182	\$106,209	\$311,666	11.9 %
RSSH: Përgjigjet dhe sistemet e komunitetit	\$6,750	\$7,050	\$11,550	\$9,450	\$34,800	\$28,380	\$29,450	\$9,450	\$16,250	\$83,530	\$13,870	\$24,450	\$16,250	\$9,450	\$64,020	\$182,350	7.0 %
Kujdesi dhe parandalimi i tuberkulozit	\$2,151		\$27,104	\$14,007	\$43,261	\$29,621	\$11,757	\$11,757		\$53,134	\$19,422	\$1,275	\$1,275	\$1,275	\$23,247	\$119,642	4.6 %
Trajtim, kujdes dhe mbështetje			\$718	\$16,726	\$17,444	\$29,381	\$29,381	\$21,676	\$6,950	\$87,388	\$2,000	\$2,000	\$2,000	\$2,000	\$8,000	\$112,832	4.3 %
Totali	\$48,526	\$179,261	\$155,787	\$257,668	\$641,242	\$251,719	\$180,764	\$154,391	\$122,672	\$709,546	\$566,297	\$377,153	\$217,173	\$98,179	\$1,258,802	\$2,609,590	100.0 %
Sipas grupimit të kostos	01/01/2020 - 01/04/2020 - 01/07/2020 - 01/10/2020 - 31/03/2020 30/06/2020 30/09/2020 31/12/2020				Totali Y1 01/01/2021 - 01/04/2021 - 01/07/2021 - 01/10/2021 - 31/03/2021 30/06/2021 30/09/2021 31/12/2021					Totali Y2 01/01/2022 - 01/04/2022 - 01/07/2022 - 01/10/2022 - 31/03/2022 30/06/2022 30/09/2022 31/12/2022					Totali Y3	Totali i Grantit	% e Totalit të Grantit
Burimet Njerëzore (HR)	\$15,626 \$60,221 \$59,037 \$60,221				\$195,104	\$46,842 \$46,842 \$46,842 \$46,842				\$187,369	\$37,923 \$37,923 \$37,923 \$37,923				\$151,693	\$534,166	20.5 %
Kostot e lidhura me	\$1,890 \$41,414				\$49,850	\$57,968 \$9,878 \$7,569				\$88,028	\$46,857 \$9,075 \$14,085				\$77,302	\$215,180	8.2 %



udhëtimet (TRC)																		
Shërbimet e jashtme profesionale (EPS)	\$6,750 \$6,750 \$13,500			\$15,806	\$42,806	\$16,250 \$46,550 \$6,750			\$12,056	\$81,606	\$37,425 \$32,175 \$31,500			\$14,306	\$115,406	\$239,818	9.2 %	
Produkte shëndetësore - Produkte farmaceutike (HPPP)	\$18,750 \$18,750 \$18,750			\$18,750	\$75,000	\$15,000 \$15,000 \$15,000			\$15,000	\$60,000	\$15,000 \$15,000 \$15,000			\$15,000	\$60,000	\$194,999	7.5 %	
Produkte shëndetësore - produkte jo farmaceutike (HPNP)				\$12,186 \$100,763	\$112,949					\$77,576 \$26,561 \$42,297 \$26,711	\$173,145				\$90,173 \$80,129 \$15,415 \$15,415	\$201,131	\$487,225	18.7 %
Produkte shëndetësore - Pajisje (HPE)	\$80,400			\$44,333	\$124,733	\$26,483 \$26,483 \$26,483				\$79,448	\$228,450 \$194,601				\$423,051	\$627,231	24.0 %	
Kostot e menaxhimit të prokurimit dhe zinxhirit të furnizimit (PSM)											\$5,069				\$5,069	\$5,069	0.2 %	
Materiale Komunikuese dhe Publikime (CMP)	\$2,151				\$2,151	\$2,151				\$2,151	\$97,151 \$95,000				\$192,151	\$196,452	7.5 %	
Kostot indirekte dhe të përgjithshme	\$5,250 \$11,250 \$10,900			\$11,250	\$38,650	\$9,450 \$9,450 \$9,450			\$9,450	\$37,800	\$8,250 \$8,250 \$8,250			\$8,250	\$33,000	\$109,450	4.2 %	
Totali përfundimtar	\$48,526	\$179,261	\$155,787	\$257,668	\$641,242	\$251,719	\$180,764	\$154,391	\$122,672	\$709,546	\$566,297	\$377,153	\$217,173	\$98,179	\$1,258,802	\$2,609,590	100.0 %	

Sipas Përfutuesit	01/01/2020 - 31/03/2020	01/04/2020 - 30/06/2020	01/07/2020 - 30/09/2020	01/10/2020 - 31/12/2020	Totali Y1	01/01/2021 - 31/03/2021	01/04/2021 - 30/06/2021	01/07/2021 - 30/09/2021	01/10/2021 - 31/12/2021	Totali Y2	01/01/2022 - 31/03/2022	01/04/2022 - 30/06/2022	01/07/2022 - 30/09/2022	01/10/2022 - 31/12/2022	Totali Y3	Totali i Grantit	% of Grand Total
PR	\$48,526	\$127,076	\$104,418	\$203,483	\$483,503	\$213,190	\$142,234	\$115,861	\$84,143	\$555,428	\$538,205	\$349,061	\$189,081	\$70,087	\$1,146,432	\$2,185,363	83.7 %
Ministria e Shëndetësisë Republikës Shqiptare	\$48,526	\$127,076	\$104,418	\$203,483	\$483,503	\$213,190	\$142,234	\$115,861	\$84,143	\$555,428	\$538,205	\$349,061	\$189,081	\$70,087	\$1,146,432	\$2,185,363	83.7 %
SR		\$52,185	\$51,370	\$54,185	\$157,740	\$38,529	\$38,529	\$38,529	\$38,529	\$154,118	\$28,092	\$28,092	\$28,092	\$28,092	\$112,370	\$424,227	16.3 %
NGO MSM		\$12,120	\$12,120	\$12,120	\$36,360	\$8,484	\$8,484	\$8,484	\$8,484	\$33,936	\$6,060	\$6,060	\$6,060	\$6,060	\$24,240	\$94,536	3.6 %
NGO OST		\$14,310	\$14,310	\$14,310	\$42,930	\$10,017	\$10,017	\$10,017	\$10,017	\$40,068	\$7,155	\$7,155	\$7,155	\$7,155	\$28,620	\$111,618	4.3 %
NGO PLHIV			\$718	\$2,000	\$2,718	\$2,000	\$2,000	\$2,000	\$2,000	\$8,000	\$2,000	\$2,000	\$2,000	\$2,000	\$8,000	\$18,718	0.7 %
NGO PWID PRISON		\$21,150	\$21,150	\$21,150	\$63,450	\$14,805	\$14,805	\$14,805	\$14,805	\$59,220	\$10,575	\$10,575	\$10,575	\$10,575	\$42,300	\$164,970	6.3 %
NGO SW		\$4,605	\$3,072	\$4,605	\$12,282	\$3,224	\$3,224	\$3,224	\$3,224	\$12,894	\$2,303	\$2,303	\$2,303	\$2,303	\$9,210	\$34,386	1.3 %
Totali përfundimtar	\$48,526	\$179,261	\$155,787	\$257,668	\$641,242	\$251,719	\$180,764	\$154,391	\$122,672	\$709,546	\$566,297	\$377,153	\$217,173	\$98,179	\$1,258,802	\$2,609,590	100.0 %

**URDHËR****Nr. 158, datë 28.3.2022**

**PËR MIRATIMIN E STANDARDEVE
PROFESIONALE PËR DREJTUESIT
E INSTITUCIONEVE ARSIMORE
PARASHKOLLORE**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 26, të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe shkronjave “d” dhe “ë”, të pikës 5, të kreut III, të vendimit nr. 98, datë 27.2.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit parauniversitar”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e standardeve profesionale për drejtuesit e institucioneve arsimore parashkollore, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë; Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar; Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar; drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar; zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet e arsimit parashkollor, publike dhe private.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT**Evis Kushi**

**STANDARDET PROFESIONALE PËR
DREJTUESIT E INSTITUCIONEVE
ARSIMORE PARASHKOLLORE**

Tetor, 2021**Tiranë**

Dokumenti i *Standardeve profesionale për drejtuesit e kopshteve* synon t'i ndihmojë drejtuesit në zhvillimin e detyrave, përgjegjësi dhe funksioneve brenda institucioneve arsimore që drejtojnë.

Zyra e UNICEF-it në Shqipëri, në bashkëpunim me Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë

së Arsimit Parauniversitar, mundësoi përgatitjen e këtij dokumenti.

Standardet u hartuan nën kujdesin e znj. Mirlinda Bushati, drejtuese e Programit të Edukimit dhe Fëmijërisë së hershme në UNICEF në Shqipëri, të z. Gerti Janaqi, drejtor i përgjithshëm i Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar dhe të znj. Shqiponja Lamçe, MAS.

Opinionet dhe sugjerimet e paraqitura në këtë dokument i përkasin autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht këndvështrimet e UNICEF-it.

Koordinimi për hartimin e dokumentit u krye nga znj. Aurela Zisi.

Hartues të dokumentit:

- Dr. Aurela Zisi

- Dr. Lindita Lutaj

Konsulentë të dokumentit:

- Msc. Eniana Veli

- Msc. Majlinda Uca

Redaktimi shkencor:

Dr. Dorina Rapti

Redaktimi letrar:

Elfrida Begaj

Në këtë dokument ka kontribuar edhe stafi i qendrës “Shkolla e drejtorëve të institucioneve të arsimit parauniversitar”, të cilin e falënderojmë për sugjerimet e dhëna në përgatitjen e tij.

Një falënderim i veçantë i kushtohet Shoqatës për Autonomi Vendore (SHAV), e cila përmes projektit të qeverisë zvicerane “Bashki të forta”, dha kontribut të vyer në plotësimin e dokumentit të standardeve nga këndvështrimi i pushtetit lokal dhe mundësoi diskutimin e tij me drejtuesit e kopshteve të bashkive të: Shkodrës, Durrësit, Kukësit, Korçës dhe Vlorës.

TABELA E PËRMBAJTJES

**PJESA I. DREJTIMI DHE MENAXHIMI I
INSTITUCIONEVE ARSIMORE**

Funksionet administrative dhe pedagogjike të drejtuesit të institucionit arsimor parashkollor

Cilësitë personale dhe profesionale të drejtuesit të një institucioni arsimor parashkollor

**PJESA II. STANDARDET PROFESIONALE
TË DREJTORIT TË INSTITUCIONIT TË
ARSIMIT PARASHKOLLOR**

Vlefshmëria dhe qëllimi i standardeve të drejtorit



Organizimi dhe struktura e standardeve të drejtorit të institucionit të arsimit parashkollor

Standardi hyrës – Etika dhe komunikimi

Standardi 1. Misioni, vizioni dhe plani i zhvillimit të kopshtit

Standardi 2. Udhëheqja e ndryshimeve brenda institucionit arsimor

Standardi 3. Zhvillimi dhe rritja profesionale

Standardi 4. Zbatimi i kurrikulës dhe mësimdhënia me fëmijën në qendër

Standardi 5. Partneriteti kopsht-familje-komunitet dhe bashkëpunimet ndërinstitucionale

Standardi 6. Menaxhimi i burimeve njerëzore dhe financiare

BIBLIOGRAFIA

PJESA I

DREJTIMI DHE MENAXHIMI I INSTITUCIONEVE ARSIMORE

Arsimi parashkollor është niveli i parë i edukimit që lidhet drejtpërdrejt me zhvillimin, të nxënit dhe mirëqenien e fëmijëve të moshës nga tre- deri gjashtëvjeçare. Arsimi parashkollor synon zhvillimin intelektual, fizik dhe shoqëror të çdo fëmije, ushtrimin e rregullave themelore të sjelljes e të higjienës, kultivimin e vlerave, si dhe përgatitjen e fëmijëve për arsimin fillor².

Ligji i arsimit parauniversitar kërkon nga drejtuesi të drejtojë veprimtarinë e institucionit arsimor, duke qenë përgjegjës për përmirësimin e cilësisë së shërbimit arsimor, për zbatimin dhe zhvillimin e kurrikulës, për menaxhimin e burimeve njerëzore, si dhe menaxhimin e burimeve financiare.

Drejtimi i institucionit arsimor parashkollor mbështet një praktikë etike që zbatohet brenda kuadrit të planit të zhvillimit të kopshtit. Drejtuesi i kopshtit bashkëpunon me të gjitha palët e interesuara për të ndikuar në krijimin e imazhit të institucionit, të vlerave individuale dhe kolektive, në filozofinë e të nxënit të vazhdueshëm, në përmbushjen e pritshmërive dhe në mbështetjen e komunitetit.

Përveç zotërimit të njohurive në fusha të veçanta, si: të *kuptuarit* si zhvillohen dhe nxënë fëmijët parashkollorë, si *bashkëpunohet* me prindërit

për t'i kthyer në partnerë më të fuqishëm të kopshtit, si *monitorohet* dhe *ndihmohet* stafi të përmirësojë veprimtarinë mësimore-edukative, drejtuesi, duhet të jetë njohës i mirë i gjithë *sistemit të arsimit parashkollor*, i proceseve dhe i *ndryshimeve* të rëndësishme që ndodhin te fëmijët gjatë fëmijërisë së hershme, i *politikave* që lidhen me zhvillimet, ndërhyrjet dhe reformat që ndikojnë në cilësinë e shërbimeve ndaj fëmijëve, prindërve dhe komunitetit.

Çdo institucion arsimor ka natyrë dinamike në kontekstin e drejtimit. Veprimet drejtuese dhe stili i drejtimit varen nga konteksti ku veprohet dhe lidhen me faktorë të shumtë që ndikojnë në fuqinë dhe cilësinë e drejtimit.

Drejtesia është personi që motivon stafin, komunitetin, fëmijët dhe në mënyrë të vazhdueshme kupton dhe përmirëson cilësinë e shërbimeve të ofruara nga institucioni që ai drejton. Gjate punës, drejtuesi duhet të përballojë situata sfiduese, komplekse, të pasigurta dhe të bashkëpunojë për të gjetur zgjidhjet e duhura. Drejtimi është:

- *Operacional*. Drejtuesi është i angazhuar me komunikimin, organizimin dhe menaxhimin e burimeve brenda kopshtit;

- *Racional*. Drejtuesi mendon, kupton, vlerëson dhe vepron i udhëhequr nga parimet që e ndihmojnë të arrijë objektivat e vendosur. Ai zhvillon në mënyrë të vazhdueshme konsultime dhe marrje *feedback*-u për të përmirësuar, zhvilluar më tej dhe zgjeruar marrëdhëniet me fëmijët, stafin dhe komunitetin;

- *Strategjik*. Drejtuesi udhëheq me plan strategjik, të mirëmenduar, me qëllime afatshkurtra dhe afatgjata;

- *Sistematik*. Drejtuesi bën vlerësime të brendshme në mënyrë të vazhdueshme dhe periodike për të njohur efektivitetin e mënyrës si e drejton institucionin.

Drejtimi është faktor i rëndësishëm ndikues:

- në cilësinë e shërbimit që u ofrohet fëmijëve parashkollorë;

- në përmirësimin e praktikave të punës së përditshme;

- në politikat institucionale;

- në marrëdhëniet ndërinstitucionale.

² Ligji nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, neni 21.



Funksionet administrative dhe pedagogjike të drejtuesit të institucionit arsimor parashkollor

Funksionet që kryen drejtuesi i institucionit arsimor parashkollor janë *administrative* dhe *pedagogjike*. Këto funksione kërkojnë që drejtuesi të krijojë mjedisin dhe kushtet e duhura për t'i përmbushur. Ato lidhen me krijimin e frymës së bashkëpunimit brenda institucionit, me rritjen profesionale, me mbështetjen e vazhdueshme, me qartësinë e politikave dhe të procedurave, me sistemin e vlerësimit, me proceset e vendimmarrjes, me vendosjen e qëllimeve të përbashkëta, me ndarjen e detyrave, me sistemimin e mjedisit fizik dhe me frymën inovative.

Komunikimi, negocimi, bashkëpunimi, marrëdhëniet ndërpersonale, dhënia dhe marrja e informacioneve, pranimi dhe dashuria e fëmijëve hyjnë te detyrat kryesore të një drejtuesi. Gjithashtu, detyrë e tij është krijimi i kulturës dhe i imazhit të institucionit mbështetur në norma, vlera, besime dhe qëndrime që demonstrohen nga i gjithë stafi pedagogjik dhe punonjësit mbështetës.

Funksionet administrative kanë të bëjnë me:

- *funksionet* strategjike, siç janë *përvaktimi* i misionit dhe i vizionit të qartë për krijimin e një kulture pozitive, miqësore e gjithëpërfshirëse, *i drejtimit* nga duhet ecur dhe punuar, *planifikimi* i mirëmbledhur për përmirësimin e institucionit, *vendosja* e qëllimeve të qarta për një institucion me një të ardhme më të mirë, *bashkëpunimi* me komunitetin, partnerët dhe sistemin;

- *udhëheqjen* e ndryshimeve që vijnë nga vendimmarrja. Zbatimi i ndryshimeve është i lidhur sa me ndryshimin e mënyrës së të menduarit, aq edhe me ndryshimin e praktikave apo të parimeve të një institucioni, sidomos në rastin kur do të zbatohen politika, reforma apo strategji kombëtare. Parë në këtë këndvështrim, drejtuesi duhet të kujdeset edhe për udhëheqjen e stafit drejt ndryshimit të synuar, mirëqenien e tij dhe motivimin për të ecur me besim drejt ndryshimit. Ndjenja e pasigurisë, presioni dhe rezistenca ndaj ndryshimit ndikojnë në uljen e efektivitetit të performancës së institucionit;

- *burimet njerëzore*, që lidhen me menaxhimin dhe drejtimin e personelit drejt përmbushjes së qëllimeve të institucionit, me menaxhimin e proceseve, të detyrave, krijimin e marrëdhënieve pozitive, mbështetjen dhe motivimin e stafit për të

punuar në mënyrë efektive, nxitjen e stafit për të përmirësuar vazhdimisht veten dhe performancën profesionale, zgjidhjen e konflikteve dhe komunikim efektiv me çdo individ, brenda dhe jashtë institucionit;

- *qëndrueshmërinë* e kulturës së punës, me qëllimin e krijimit të praktikës së të nxëniet në bashkëpunim, të krijimit të një klime të përgjithshme pozitive, ku i gjithë institucioni punon në interes të komunitetit dhe përmbush nevojat e tij;

- *burimet financiare*, për menaxhimin, shfrytëzimin e të ardhurave, të kontributeve dhe përdorimin e tyre sipas nevojave institucionale;

- *bashkëpunimin* me komunitetin, partnerët dhe grupe të tjera interesi me qëllim ofrimin e shërbimeve cilësore të dëshiruara nga prindërit, komuniteti dhe shoqëria për të mirën e fëmijëve sot dhe për të ardhmen e shoqërisë nesër. Drejtuesi luan dhe rolin e advokuesit, sepse ai përcjell zërin e fëmijëve, të familjeve dhe qytetarëve dhe ndërmjetëson për të përmirësuar cilësinë në çdo aspekt të punës në kopsht.

Funksionet pedagogjike të drejtuesit përfshijnë aspekte që kanë të bëjnë me përmirësimin dhe përditësimin e praktikave të mësimdhënies, me zbatimin e kurrikulës dhe me edukimin cilësor të fëmijëve. Në këtë këndvështrim, drejtuesi është ura lidhëse ndërmjet zhvillimeve teorike dhe zbatimeve praktike. Funksionet pedagogjike lidhen me:

- *krëjimin* e kulturës së bashkëpunimit e të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të stafit me synim rritjen profesionale, evidentimin e nevojave për trajnime, si dhe pjesëmarrjen e përgjegjshme në këto veprimtari;

- *zbatimin* e kurrikulës, duke respektuar dokumentet kurrikularë, parimet dhe kërkesat mbi të cilat është hartuar kurrikula dhe pritjet të planifikohet, të zbatohet dhe të vlerësohet nga mësuesit;

- *zbatimin* e mësimdhënies me fëmijën në qendër, duke i siguruar stafit kushte më të mira për mësimdhënie cilësore;

- *koherencën* me zhvillimet ndërkombëtare dhe përmirësimin e arritjeve të fëmijëve parashkollorë;

- *forcimin* e bashkëpunimit dhe të zhvillimit të marrëdhënieve të shëndosha të besimit dhe të respektit brenda njerëzve që punojnë në institucion. Drejtuesi, duke njohur natyrat e grupeve, dinamikat, konfliktet, strategjitë e zgjidhjes



paqësore së tyre i mundëson stafit të përfshihet në trajtimin e aspekteve pedagogjike për përballimin e sfidave që dalin në punën e përditshme;

- *bashkëpunimin* dhe krijimin e një partneriteti pozitiv me prindërit dhe familjen për zhvillimin e kompetencave themelore për të gjithë fëmijët. Proceset edukative që fëmija merr në familje kanë një ndikim të madh në të gjitha fushat e tij të zhvillimit. Pjesë të diskutimeve me prindërit, drejtuesi ka jo vetëm informimin rreth aspekteve organizative, por edhe çështje të ndryshme mësimore e edukative.

Cilësitë personale dhe profesionale të drejtuesit të një institucioni arsimor parashkollor

Drejtuesi ka një detyrë komplekse që lidhet me përgjegjësitë dhe detyrat, me përditësimin e njohurive dhe të aftësitë që duhet të zotërojë, me vlerat që duhet të performojë brenda dhe jashtë institucionit të arsimit parashkollor.

Cilësitë personale dhe profesionale përbëjnë kompetencat e drejtuesit. Ato ndikojnë në përmbushjen e objektivave, në përdorimin me efikasitet të burimeve njerëzore dhe financiare, në demonstrimin e niveleve të larta të performancës dhe të profesionalizmit të punonjësve arsimorë dhe në ofrimin e një shërbimi arsimor cilësor, për fëmijët dhe komunitetin.

Kompetenca e komunikimit është aftësia e drejtuesit të kopshtit për të transmetuar dhe shkëmbyer çdo informacion në mënyrë efektive. Drejtuesi komunikon qartë, saktë e në mënyrë bindëse misionin, vizionin, synimet, objektivat dhe çdo udhëzim brenda dhe jashtë institucionit, nëpërmjet të gjitha formave të komunikimit. Drejtuesi duhet të komunikojë, të negociojë, të bashkëpunojë dhe të advokojë në mënyrë efektive. Ai është dëgjues i mirë, bashkëpunues, i qartë në përgjigje dhe në gjendje të japë e të marrë *feedback*.

Kompetenca e planifikimit dhe e administrimit lidhet me detyrat e drejtuesit të kopshtit. Krijimi i klimës pozitive në institucion, i kulturës mbështetëse në drejtim të të nxënës dhe zhvillimit profesional, motivimi i stafit, përmirësimi i vazhdueshëm i kushteve të punës, pjesëmarrja dhe përfshirja në vendimmarrje, ndikojnë në cilësinë e proceseve dhe të shërbimeve të ofruara nga i gjithë stafi i kopshtit.

Në një institucion punojnë njerëz me njohuri, aftësi të ndryshme dhe të dallueshme nga njëri-tjetri. Drejtuesi duhet të jetë njohës i mirë i

punonjësve, me qëllim shfrytëzimin sa më efektiv të aftësive që zotërojnë.

Drejtuesi duhet të luajë një rol proaktiv në drejtim të *menaxhimit të konflikteve*. Në çdo institucion lindin keqkuptime, probleme, konflikte dhe situata të pakëndshme. Drejtuesi është ai që me njohuritë dhe aftësitë e duhura mundëson parandalimin, menaxhimin, kompromisin dhe zgjidhjen e tyre.

Kompetenca e punës në ekip. Çdo institucion funksionon si një skuadër dhe *puna në ekip* është kusht për garantimin e suksesit. Drejtuesi ka ndikim të madh në *motivimin* e njerëzve, në krijimin e një klime nxitëse dhe motivuese brenda institucionit që drejton, duke i trajtuar punonjësit me dinjitet dhe respekt, duke ndërtuar komunikim konstruktiv, të hapur dhe të ndershëm.

Një aspekt tjetër motivimi, është qëndrimi i drejtuesit në lidhje me gabimet që bëhen në institucion. Njerëzit që punojnë, që marrin përgjegjësi, kërkojnë ndryshime ose sfida për të përballuar, mundet edhe të bëjnë gabime gjatë punës dhe të mos i përmbushin detyrimet apo qëllimet e caktuara në kohën ose në cilësinë e dëshiruar. Drejtuesi ndaj gabimeve, përdor më tepër, forma të diskutimit konstruktiv para masave ndëshkuese.

Kompetenca e veprimit strategjik ka të bëjë me kuptimin e misionit, të vizionit, synimit, objektivave, vlerave të institucionit dhe përputhjen me to, të veprimeve të punonjësve të kopshtit. Krijimi i misionit, i vizionit dhe përcaktimi i synimeve kryhet sipas legjislacionit që mundëson përmbushjen e tyre. Objektivat që rrjedhin prej tyre janë specifike, të matshme, të arritshme, të realizueshme dhe të gjurmueshme. Drejtuesi është nxitës i ndryshimeve dhe i mundësive, që do të sjellin përmirësime dhe frymëzues i punonjësve që zbatojnë mënyra të reja të të bërit të gjërave. Ai ndërton besim në komunitet duke krijuar një atmosferë pozitive për zhvillimin, të nxënës dhe mirëqenien e fëmijëve parashkollorë.

Kompetenca e vetëmenaxhimit përcakton vetëdërgjegjësimin dhe zhvillimin e aftësive njerëzore, konceptuale dhe analitike. Drejtuesi është në gjendje të përballojë sfida e të gjejë zgjidhje pozitive në bashkëpunim me të tjerët. Ai e di kur duhet të marrë vendime, të informojë dhe t'i komunikojë ato.



Drejtuesi ka përgjegjësinë për ta ndihmuar stafin të bëjë punën e vet. Për ta arritur këtë, punonjësit duhet të pajisen me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të zhvilluar veten dhe për të dhënë më të mirën në punën e përditshme në institucion. Për një drejtim dhe menaxhim të kopshtit, duhet që drejtuesi të vlerësojë rëndësinë e inteligjencës emocionale, të empatisë, qëndrueshmërisë dhe të mirëqenies vetjake. Drejtuesi në mënyrë të rregullt rishikon praktikën dhe bën ndryshime në varësi të situatës. Ai menaxhon veten duke përdorur praktika etike dhe shprehje sociale për të përballuar me efikasitet problemet e institucionit.

PJESA II

STANDARDET PROFESIONALE TË DREJTORIT TË INSTITUCIONIT TË ARSIMIT PARASHKOLLOR

Drejtimi është i rëndësishëm në cilësinë dhe suksesin e edukimit. Drejtimi është aftësi për të zhvilluar vizione, për të bërë ndryshime që udhëheqin përmirësimin e klimës së bashkëpunimit, mirëqenies dhe arritjeve të fëmijëve. Ai mbështetet në bashkëndarjen e vlerave, në vlerësimin e praktikave dhe të rezultateve të arritura. Drejtori i frymëzon, krijon mundësi, dhe mbështet punonjësit të zhvillojnë dhe të ndjekin strategji të caktuara për të bërë ndryshime.

Vlerat profesionale janë në zemër të çdo drejtuesi. Ai, frymëzon dhe motivon stafin, fëmijët, prindërit dhe komunitetin duke vendosur pritshmëri më të larta për aspekte të ndryshme të jetës, të edukimit dhe të veprimtarisë së kopshtit.

Drejtori kupton praktikën dhe teorinë bashkëkohore që lidhen me liderhipin, është i përditësuar me zhvillimet më të fundit në politikën arsimore, për nismat, legjislacionin, marrëveshjet dhe praktikën ndërkombëtare për fëmijërinë e hershme. Ai është i mirinformuar për zhvillimet në fushën e mësimdhënies, të zhvillimit dhe të të nxënies të fëmijëve në këtë moshë. Drejtori kujdeset për menaxhimin e performancës së kopshtit, zbaton njohuritë rreth drejtimit, koncepteve dhe praktikave menaxheriale, dhe i ndan me të tjerët strategjitë efektive të të nxënies dhe të menaxhimit operacional.

Vlefshmëria dhe qëllimi i standardeve të drejtorit

Dokumenti i standardeve profesionale synon ta ndihmojë drejtorin e kopshtit në zhvillimin e detyrave, të përgjegjësiave dhe funksioneve brenda institucionit arsimor që drejton. Standardet përcaktojnë se çfarë duhet të dijë, të përmbushë dhe të demonstrojë drejtori për të pasur sukses në drejtimin e institucionit.

Gjithashtu, ato e orientojnë atë që mënyra dhe stili i tij i drejtimit ka ndikim pozitiv te stafi pedagogjik, fëmijët, prindërit, komuniteti dhe grupet e tjera të interesit. Standardet tregojnë, që:

- drejtori i suksesshëm e kupton ndikimin e tij, brenda dhe jashtë institucionit;
- drejtimi është kontekstual dhe i përgjigjet nevojave të ndryshme të institucionit arsimor dhe të komunitetit;

- drejtimi i suksesshëm është sa i deleguar, po aq edhe bashkëpunues. Stafi dhe drejtuesi punojnë së bashku për të përmbushur misionin, vizionin dhe qëllimet e institucionit;

- praktikën dhe aftësitë e drejtorit përparojnë e shtimin viteve të karrierës në drejtimin e institucionit;

- pothuajse, çdo drejtues, shfaq të njëjtat praktika dhe sjellje drejtuese, mbështetur në cilësitë personale kyçe dhe në aftësitë që janë domethënëse në efektivitetin e drejtimit të institucionit.

Këto standarde janë hartuar mbi bazën e qasjes të mbështetur në kompetenca, ku, çdo drejtor institucioni duhet të zotërojë njohuritë, aftësitë dhe sjelljet që i takojnë një lideri. Standardet nxisin *kreativitetin* e çdo drejtori të ri apo me përvojë qoftë, *reflektimin* në performancën individuale dhe të institucionit që përfaqëson, dhe *arritjen* e qëllimeve sipas mënyrave individuale.

Standardet shërbejnë për të njohur profilin e zhvillimit profesional të individit. Çdo drejtor zgjedh ato trajnime që lidhen me nevojat e tij profesionale. Plani i zhvillimit profesional duhet të jetë i integruar me planin e zhvillimit institucional, diktuar nga prioritetet kombëtare dhe zhvillimet ndërkombëtare.

Standardet e drejtorit do të shërbejnë si bazë:

- për hartimin e politikave dhe të procedurave shtetërore të formimit, emërimit, zhvillimit profesional të drejtuesve të institucione arsimore, si dhe për të vlerësuar performancën e tyre;



- për hartimin e programeve të formimit të drejtorit në punë dhe të individëve që aspirojnë të bëhen të tillë, mbështetur te sjellja personale dhe profesionale, te praktika e punës së një drejtuesi, te kuadri ligjor dhe te politikat e lidhshme;

- për përzgjedhjen dhe emërimin e drejtuesve cilësorë që i përmbushin këto standarde dhe synojnë të sjellin ndryshime në drejtimin e një institucioni;

- për identifikimin e nevojave për trajnim të drejtuesve në punë;

- për të hartuar plane të zhvillimit profesional të drejtuesve të organizuar në rrjete profesionale, dhe për bërë vlerësime sistematike të performancës së drejtorëve të institucioneve arsimore;

- për hartimin e platformave të inspektimit në drejtim të cilësisë së drejtimit, si dhe të menaxhimit të institucionit parashkollor;

- për hartimin e programeve për formimin fillestar të drejtuesve, si dhe programeve për trajnimin e vazhdueshëm të drejtuesve të kopshteve;

- për zhvillimin e kurseve të zhvillimit profesional të drejtuesve, me qëllim krijimin e një vizioni të qartë lidhshme;

- për licencimin apo certifikimin e drejtorëve pas kurseve, ose pas shkollës së kryer.

Gjithashtu, standardet do t'u shërbejnë:

- drejtuesve që janë në punë, për krijimin e dosjes profesionale, për të kuptuar si po e drejtojnë institucionin, dhe për të vetëidentifikuar nevojat për trajnim dhe zhvillim profesional;

- përfaqësuesve të komunitetit në Bordin e kopshtit dhe në Këshillit të prindërve, për të kuptuar cilësinë e shërbimit arsimor që ofron institucioni parashkollor;

- institucioneve përgjegjëse, që nëpërmjet treguesve të përmbushur të standardeve, të

vlerësojnë në mënyrë periodike performancën e drejtuesit, ngritjen profesionale duke u dhënë ide për trajnime dhe kualifikime të vazhdueshme, si dhe për të hartuar udhëzime, urdhra dhe rregullore që kanë të bëjnë me punën e drejtuesit;

- institucioneve shtetërore që hartojnë politika të lidhura me zhvillimin, drejtimin dhe menaxhimin profesional të institucioneve arsimore;

- universiteteve, agjencive dhe organizatave që ofrojnë programe formimi, trajnimi dhe zhvillimi profesional të drejtuesve.

Organizimi dhe struktura e standardeve të drejtorit të institucionit të arsimit parashkollor

Standardet profesionale të drejtorit harmonizojnë njohuritë dhe të kuptuarin profesional, aftësitë profesionale, si dhe qëndrimet e vlerat profesionale të drejtuesit të institucionit parashkollor. Dokumenti përmban 1 standard hyrës, dhe 6 standarde profesionale të ndërlidhur e të ndërvarur me njëri-tjetrin:

Standardi hyrës: Etika dhe komunikimi.

1. Misioni, vizioni dhe plani i zhvillimit të kopshtit;

2. Udhëheqja e ndryshimeve brenda institucionit arsimor;

3. Zhvillimi dhe rritja profesionale;

4. Zbatimi i kurrikulës dhe mësimdhënia me fëmijën në qendër;

5. Partneriteti kopsht-familje-komunitet dhe bashkëpunimi ndër-institucional;

6. Menaxhimi i burimeve njerëzore dhe financiare.

Secili standard përmban një përshkrim të shkurtër të kuptimit dhe të përmbajtjes, pikat kyçe ku është përqendruar, si dhe treguesit specifikë kryesorë që e orientojnë drejtorin të punojë e të dëshmojë përmbushjen e çdo standardi.

Standardi hyrës – Etika dhe komunikimi

Përshkrimi i standardit

Drejtori i kopshtit drejton me respekt, integritet dhe në mënyrë etike kudo që ndodhet, brenda dhe jashtë mjedisve të institucionit arsimor. Ai sillet me integritet, bazuar në qëllime morale modelon vlera demokratike dhe qytetare.

Drejtori modelon "të nxëniet për jetën" nëpërmjet praktikës profesionale, dhe i promovon në marrëdhënie me fëmijët, stafin, prindërit dhe komunitetin.

Vlera të tilla si: drejtësia, paanësia, mosdiskriminimi, trajtimi i barabartë, dinjiteti etj. dhe parimet e dhëna në Kodin e etikës qëndrojnë në themel të drejtimit të institucionit arsimor.

Dimensionet e standardit

- Integriteti dhe sjellja etike;

- Komunikimi;

- Vlerat demokratike dhe qytetare.

Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

**Drejtori:**

- *zbaton* kodin e sjelljes, të vlerave dhe të etikës profesionale brenda dhe jashtë institucionit;
- *zbaton* rregullat e etikës dhe të komunikimit, si elemente të domosdoshme në të gjithë veprimtarinë e tij profesionale;
- *krizon* besueshmëri dhe respekt nëpërmjet sjelljeve dhe vlerave të tij;
- *përmbysh* detyrimet ligjore dhe kontraktuale;
- *sillet* në përputhje me rregullat e etikës dhe të sjelljes;
- *mbron* të drejtat dhe raportet konfidenciale të fëmijëve, prindërve dhe stafit;
- *promovon* vlerat shoqërore të të qenit njeri i hapur, i ndershëm, me integritet dhe profesionalizëm;
- *drejton* stafin mësues duke demonstruar standarde të larta profesionale ndaj sjelljeve të tyre;
- *shfaq* sjellje mirëkuptuese, motivuese dhe fuqizuese të stafit;
- *trajton* njerëzit në mënyrë të drejtë, transparente, me dinjitet dhe me respekt;
- *vishet* me veshjen e duhur në kopsht;
- *merr* vendimet e duhura në rastet e dilemave etike;
- *krizon* një mjedis pozitiv që përcjell vlerat themelore të demokracisë.

Standardi 1. Misioni, vizioni dhe plani i zhvillimit të kopshtit**Përshkrimi i standardit**

Drejtori i kopshtit zhvillon, mbron dhe miraton misionin e përbashkët, vizionin dhe vlerat thelbësore të arsimit me cilësi të lartë për zhvillimin dhe të nxëniet e fëmijëve. Drejtori përfaqëson interesat më të larta të komunitetit të cilat janë të shprehura në vizionin strategjik, kulturën, traditat dhe etosin që promovohen në kopsht.

Vizioni ndahet dhe mbështetet nga i gjithë komuniteti shkollor. Drejtori në bashkëpunim me stafin e kopshtit, përdor metodat më të frytshme për zhvillimin e vizionit. Ai e shndërron procesin e vlerësimit të brendshëm të kopshtit, në një kulturë të vijueshme pune, për të siguruar përmirësim të vazhdueshëm të planit të zhvillimit.

Drejtori monitoron dhe vlerëson realisht çdo veprimtari të kopshtit, duke vepruar si agjent i përmirësimit të shërbimeve që sigurojnë suksesin dhe mirëqenien e çdo fëmije. Drejtori përdor teknika të larmishme të mbledhjes e menaxhimit të informacionit, të analizës së të dhënave dhe nxjerrjes së përfundimeve.

Dimensionet e standardit

- *Misioni, vizioni dhe ndërtimi i imazhit të institucionit;*
- *Plani i zhvillimit;*
- *Kultura e përmirësimit të vazhdueshëm;*
- *Rishikimi i përparësive, i synimeve dhe i objektivave.*

Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**Drejtori:**

- *zbaton* ligjet dhe aktet nënligjore të arsimit, politikat, proceset dhe skemat kombëtare të reformave arsimore; *lidh* misionin e kopshtit me zhvillimin, të nxëniet dhe mirëqenien e çdo fëmije;
- *zhvillon* vizionin e kopshtit brenda kornizës legjislative të politikës arsimore shqiptare, praktikave bashkëkohore dhe kontekstit lokal;
- *përfshin* të gjithë anëtarët e komunitetit të kopshtit për përmbyshjen e vizionit, duke vlerësuar kontributet që jep secili prej tyre;
- *drejton* grupet e punës për hartimin dhe zbatimin e planeve zhvillimore strategjike në përmbyshje të vizionit të kopshtit, duke përcaktuar qartë përparësitë, synimet, objektivat, veprimtaritë kryesore, produktin ose treguesit e arritjeve, si dhe buxhetin e përafërt;
- *identifikon* pengesat e mundshme për realizimin e përparësive dhe të objektivave të kopshtit dhe i adreson për zgjidhje;
- *shndërron* procesin e vlerësimit të brendshëm të kopshtit në një kulturë të vijueshme pune, bazuar në vlerësimet objektive, duke lidhur planin e përmirësimit me planin e zhvillimit të kopshtit;
- *rishikon* misionin dhe vizionin e kopshtit, duke i përshtatur me ndryshimin e pritshmërive, mundësitë e kopshtit, si dhe ndryshimin e nevojave dhe të interesave të fëmijëve;
- *përdor* teknika të përshtatshme të mbledhjes, menaxhimit, analizës së të dhënave, dhe përpunimit të tyre;
- *siguron* transparencë, besueshmëri dhe integritet gjatë përdorimit të të dhënave;
- *bashkëpunon* me njësinë e qeverisjes vendore, Zyrrën vendore të arsimit dhe partnerë të tjerë, për t'u mbështetur në proceset e planifikimit, të zbatimit, të monitorimit dhe të vlerësimit.



Standardi 2. Udhëheqja e ndryshimeve brenda institucionit arsimor

Përshkrimi i standardit

Drejtori udhëheq përmirësimin në bazë të ndryshimeve. Ai punon me të tjerët për të krijuar dhe zbatuar plane dhe politika të qarta përmirësimi për zhvillimin e kopshtit.

Drejtori pranon se një pjesë e rëndësishme e rolit të tij është të udhëheqë dhe të menaxhojë inovacionin dhe përmirësimin, të lidhura me vizionin dhe vlerat e institucionit që drejton, dhe që diktobet nga rezultatet e zhvillimit dhe të të nxënësve. Ai u tregon prindërve dhe komunitetit nevojën për ndryshime në mënyrë frymëzuese dhe logjike.

Drejtori motivon dhe ndihmon stafin të kuptojë se, ndryshimi dhe e reja kanë ndikim pozitiv në zhvillimin dhe të nxënësve të fëmijëve.

Dimensionet e standardit

- Zhvillimi nëpërmjet krijimtarisë, risive dhe teknologjisë;
- Kryerja e ndryshimeve brenda institucionit diktuar nga kuadri ligjor, strategjitë dhe reformat në arsim, dhe shërbimet që ofrohen nga njësitë e qeverisjes vendore;
- Promovimi i zhvillimit të kompetencave të të nxënësve gjatë gjithë jetës;
- Përdorimi i teknologjive të reja në mësimdhënie dhe në të nxënësve.

Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Drejtori:

- drejton dhe menaxhon ndryshimet brenda institucionit;
- motivon stafin, fëmijët, prindërit dhe komunitetin e gjerë për të pasur pritshmëri, cilësi dhe performancë të lartë;
- prezanton tek të tjerët cilësi të larta të sjelljes profesionale;
- krijon në institucion klimën e të nxënësve bashkëpunues;
- është fleksibël në menaxhimin e problematikave që sjellin ndryshimet në sistemin arsimor;
- mbështet zhvillimin e sistemit arsimor në tërësi, duke bashkëpunuar me të tjerët dhe duke ndarë njohuritë dhe praktikat pozitive;
- vlerëson gjithëpërfshirjen, si një proces që sjell përfitime, duke bërë që secili në kopsht fëmijë, prind, staf të jetë pranues, jodiskriminues dhe mbështetës ndaj të tjerëve;
- kontribuon në ndërtimin e kopshteve si komunitete të dijes e të zhvillimit që respektojnë, nxisin dhe vlerësojnë aftësitë e të gjithëve;
- zbaton legjislacionin dhe vlerat shqiptare për respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Standardi 3. Zhvillimi dhe rritja profesionale

Përshkrimi i standardit

Një drejtues efektiv zhvillon veten dhe të tjerët. Ai punon me dhe nëpërmjet të tjerëve për të ndërtuar një komunitet profesional të nxënësi që ka si qëllim, përmirësimin e mësimdhënies dhe të të nxënësve. Nëpërmjet menaxhimit të performancës së vazhdueshme profesionale, drejtori mbështet stafin të arrijë rezultate të larta dhe merr feedback për aftësitë e tij drejtuese. Ai mbështet stafin të ndërtojë kapacitete dhe i trajton në mënyrë të drejtë, të ndershme dhe me respekt.

Drejtori krijon një model të mirë drejtimi, dhe përfshihet në zhvillimin profesional për të menaxhuar kompleksitetin e rolit të tij drejtues. Ai zhvillon dhe zbaton një vizion personal dhe organizacional që lidhet me të nxënësve, dhe zhvillimin e veprimtarive që përmirësojnë mirëqenien e përgjithshme brenda institucionit. Drejtori punon me stafin për të identifikuar dhe për të nxjerrë prioritetet dhe nevojat për zhvillim profesional, mbështetur në hendeqet dhe kërkesat ndërmjet njohurive aktuale dhe të aftësive që zotëron.

Drejtori modelon të nxënësit personal dhe profesional që dukshëm lidhet me vizionin dhe qëllimet e institucionit. Trajnimet dhe kurset që ndjek ai dhe stafi pedagogjik ndikojnë në krijimin e një mjedisi gjithëpërfshirës, në përmirësimin e praktikave të punës me fëmijët, në përshtatjen e metodave të mësimdhënies, të nevojave të ndryshme të fëmijëve, në arritjen e rezultateve të larta në punë, në koordinimin më të mirë të punës me stafin ndihmës etj. Këto veprimtari mund të jenë të inicjuara prej tij, të kërkuara nga institucioni shkollore, ose të diktuar nga nevoja për trajnim dhe kualifikim të vazhdueshëm.

Dimensionet e standardit

- Zhvillimi profesional;
- Krijimi i klimës pozitive që mbështet bashkëpunimin dhe zhvillimin profesional;
- Reflektimi mbi praktikën, proceset dhe sistemet e vetëvlerësimit;
- Krijimi dhe komunikimi në ekip.

Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Drejtori:

- planifikon dhe menaxhon planin vjetor të zhvillimit të brendshëm profesional të punonjësve të institucionit arsimor;
- nxit dhe kontrollon pjesëmarrjen e stafit në rrjetet profesionale;
- merr pjesë në rrjetet profesionale të drejtuesve, duke ndarë risitë dhe praktikën e frytshme;
- zhvillon aftësi pedagogjike dhe drejtuese të stafi pedagogjik;
- kontribuon pozitivisht në diskutime, debate, dialogë dhe mendimtarje, duke respektuar individualitetin e secilit anëtar të stafit;
- zhvillon një kulturë pune të bazuar në dëshmi, evidenca, reflektim dhe vetëvlerësim të ndershëm;
- konsideron vlerësimin si një mjet mbështetës për përmirësimin e institucionit;



- *nxit* stafin të lexojë literaturë bashkëkohore profesionale, të shfrytëzojë *site* të sigurtat interneti dhe burime të tjera informacioni, mundëson shkëmbimin e vizitave me kopshte të tjera;
- *analizon* dhe trajton në mënyrë pozitive dhe profesionale arritjet e institucionit dhe dobësitë e stafit, duke i përkrahur individët për t'u zhvilluar dhe për t'u përmirësuar;
- *përfshihet* në vetëreflektim të vazhdueshëm, për të përmirësuar praktikën profesionale dhe drejtuese;
- *nxit* në mënyrë të vazhdueshme stafin për t'u përfshirë në veprimtari kualifikuese të iniciuara nga ata vetë, ose të kërkuara nga institucioni;
- *tregon* tolerancë *zero* ndaj korrupsionit ose favorizimit të padrejtë, në përputhje me politikat zyrtare për burimet njerëzore.

Standardi 4. Zbatimi i kurrikulës dhe mësimdhënia me fëmijën në qendër

Përshkrimi i standardit

Një drejtues drejton zbatimin e kurrikulës, mësimdhënien dhe të nxënësve me fëmijën në qendër. Ai kujdeset që stafi pedagogjik të zbatojë kurrikulën e arsimit parashkollor në përputhje me zhvillimin moshor, psikologjik, interesat, mundësitë dhe dëshirat e fëmijëve të kësaj moshe. Veprimtaritë që kryhen në kopsht e ndihmojnë çdo fëmijë të ndërtojë kompetencat dhe të fitojë njohuri të reja duke u mbështetur në ato ekzistuese.

Drejtori krijon një kulturë pozitive të sfidave dhe të mbështetjes, duke nxitur mësimdhënien efektive. Ai ka përgjegjësi për zhvillimin e kulturës së mësimdhënies efektive, për drejtimin e institucionit, dizënjimin dhe menaxhimin e cilësisë së mësimdhënies, të zhvillimit dhe të nxënësve të çdo fëmije. Në mënyrë sistematike, drejtori bashkëpunon me stafin në planifikim, monitorim dhe rishikimin e efektivitetit të të nxënësve.

Drejtori rrit vlerat e institucionit që drejton, mbështet praktikën gjithëpërfshirëse, dhe vendos pritshmëri që të gjithë fëmijët të përmirësohen dhe të zhvillojnë potencialin e tyre. Ndjek dinamikën në zhvillimet në fushën e edukimit të fëmijëve parashkollorë, i ndan me stafin dhe bashkëpunon në planifikimin e veprimtarive më të mira të mësimdhënies dhe të të nxënësve.

Drejtori ka prioritet krijimin e një mjedisi me fëmijën në qendër. Motivon stafin të punojë me cilësi, të studiojë literaturë dhe të përditësojë teknologjitë bashkëkohore. Rishikon vazhdimisht kurrikulën dhe zhvillon pedagogji me qëllim përmirësimin e cilësisë në mjedisin e kopshtit. Politikat e "nevojave të veçanta" kanë lidhje me zhvillimin e mësimdhënies, të të nxënësve dhe minimizimin e mospërfshirjes së fëmijëve gjatë veprimtarisë mësimore-edukative. Ai zhvillon një kulturë të ndarjes së informacioneve të vërteta, mbështetur në fakte, përvoja dhe studime.

Dimensionet e standardit

Zbatimi cilësor i kurrikulës;

Krijimi i një mjedisi marrëdhëniesh dhe respekti të ndërsjellë në funksion të procesit të mësimdhënies dhe të të nxënësve;

Krijimi me cilësi të lartë i një kulture reflektimi për zhvillimin dhe nxënësve të fëmijëve, nëpërmjet drejtimit efektiv të mësuesve;

Krijimi i mjedisve të duhura për të nxënësve;

Sigurimi i shanseve të barabarta për të nxënësve dhe të gjithë fëmijëve;

Zbatimi i teknologjisë në mësimdhënie.

Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Drejtori:

- *qëndron* i mirinformuar për zhvillimet në fushën e fëmijërisë së hershme, në rritjen dhe zhvillimin e fëmijëve parashkollorë;
- *përditëson* stafin me risitë e reformës kurrikulare në arsimin parashkollor;
- *zotëron* njohuri për arsimin gjithëpërfshirës;
- *delegon* kompetencat në mënyrë që stafi të luajë rol kyç në drejtimin e mësimdhënies, të planifikimit dhe të vlerësimit të zhvillimit dhe të të nxënësve të fëmijëve;
- *promovon* krijimtarinë, risitë dhe përdorimin e teknologjive të reja, për të rritur cilësinë e mësimdhënies dhe të të nxënësve;
- *motivon* mësuesit për të reflektuar vazhdimisht për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, të nxënësve dhe të vlerësimit të zhvillimit dhe të arritjeve të fëmijëve;
- *nxit* mësimdhënie multimediale, duke përdorur teknologji të reja që nxisin efektivitetin e të nxënësve të fëmijëve;
- *analizon* bashkë me stafin pikat e forta dhe të dobëta në procesin e mësimdhënies dhe të të nxënësve;
- *krijon* mundësi për të plotësuar nevojat e të gjithë fëmijëve gjatë zbatimit të kurrikulës;
- *krijon* mjedis të përshtatshëm, të sigurt dhe të shëndetshëm për të nxënësve dhe të gjithë fëmijëve;
- *nxit* dhe motivon stafin për përdorimin e teknologjive të reja në mbështetje të veprimtarisë mësimore-edukative dhe për të zhvilluar kompetencat e të nxënësve gjatë gjithë jetës;
- *siguron* kushte të barabarta zhvillimi dhe të nxënësve sipas fushave të standardeve për çdo fëmijë që ndjek arsimin parashkollor nga grupi i parë në të tretin;
- *planifikon, monitoron dhe vlerëson* sistematikisht duke përdorur dëshmi dhe evidenca të proceseve të mësimdhënies, të të nxënësve dhe të arritjeve, për të nxitur përmirësimin;
- *udhëzon* stafin të përzgjedhë materialet e duhura didaktike, nëpërmjet të cilave zhvillon mësimdhënie ndërvepruese dhe pranë botës së fëmijëve;
- *i mundëson* stafit pedagogjik të përdorë pajisje, të tilla si: TV DVD, video, kompjuter, projektor, platforma dhe aplikacione kompjuterike për ta bërë mësimdhënien më ndërvepruese.



Standardi 5. Partneriteti kopsht-familje-komunitet dhe bashkëpunimet ndërinstytucionale

Përshkrimi i standardit

Partneriteti kopsht - familje është themeli i ndërtimit të bashkëpunimit ndërmjet këtyre dy institucioneve për mirërritjen dhe edukimin e fëmijëve. Drejtori i kopshtit përfshin familjet dhe komunitetin në mënyrë kuptimplote dhe të dobishme për të garantuar mirëqenien e çdo fëmije parashkollor. Ai promovon suksesin e të gjithë fëmijëve, duke bashkëpunuar me familjet dhe anëtarët e komunitetit, duke iu përgjigjur interesave dhe nevojave të ndryshme dhe duke mobilizuar burimet që kanë.

Institucioni parashkollor ka për qëllim që çdo fëmijë të ndjekë me dëshirë dhe të marrë pjesë aktive në të gjitha veprimtaritë që zhvillohen në të. Drejtori nxit përfshirjen e familjes dhe të komunitetit në jetën e kopshtit dhe mban marrëdhënie pozitive me ta. Ai pranon ndërkulturat duke mbështetur nevojat e fëmijëve, të prindërve dhe komunitetit. Së bashku me stafin pedagogjik punon dhe përpaket që prindërit të jenë pjesë aktive në të gjitha proceset që lidhen me jetën dhe veprimtarinë e kopshtit.

Drejtori ngre organizma brenda kopshtit dhe punon për të krijuar një mjedis ndërkulturore, duke ndarë të njëjtën filozofi për gjithëpërfshirjen. Ai bashkëpunon me prindërit për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme, tërheq mendimin e tyre për të përmirësuar cilësinë e punës me fëmijët, i shikon si partnerë në procesin e edukimit dhe të mirërritjes së fëmijëve.

Drejtori bën të mundur që kopshti të shërbejë si qendër komunitare, si një vend ku stafi pedagogjik, prindërit dhe anëtarë të tjerë të komunitetit zhvillojnë veprimtari dhe aktivitete të përbashkëta gjatë vitit shkollor.

Dimensionet e standardit

- Kopshti, familja dhe komuniteti;
- Zbatimi i politikave gjithëpërfshirëse nën frymën e një kulture bashkëpunimi;
- Partneriteti si pjesë e misionit dhe e vizionit të institucionit.

Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Drejtori:

- krijon bashkëpunime me institucionet e tjera dhe me rrjetet profesionale për të ndarë praktikatat të suksesshme;
- krijon dhe mban marrëdhënie pozitive, bashkëpunuese dhe produktive me familjet dhe komunitetin, duke i bërë pjesëmarrës në vendimmarrje të rëndësishme për jetën dhe veprimtarinë e kopshtit;
- krijon dhe ruan një partneritet të frytshëm nëpërmjet komunikimeve formale dhe joformale;
- bashkëpunon në projekte dhe veprimtari të përbashkëta me grupet e interesit, për përmirësimin e institucionit;
- identifikon grupet e interesit, pritshmëritë e tyre dhe ndërvepron për të përmbushur përparësitë dhe objektivat e kopshtit;
- motivon stafin, fëmijët, prindërit dhe komunitetin e gjerë për të pasur pritshmëri dhe performancë të lartë;
- përdor burimet e vëna në dispozicion nga komuniteti për të ndihmuar kopshtin të zgjidhë problemet, dhe të arrijë objektivat e tij;
- bashkëpunon dhe krijon marrëdhënieve të ndërsjella me kopshte të tjerë, për të shkëmbyer praktikatat më të mira;
- komunikon dhe bashkëpunon me familjarët me prejardhje të ndryshme kulturore, etnike, gjuhësore dhe shoqërore për krijimin e kulturës dhe të praktikave gjithëpërfshirëse;
- vlerëson gjithëpërfshirjen si një proces fitimprurës, duke bërë që secili fëmijë, prind, pjesëtar i stafit të jetë i pranuar, jo i diskriminuar dhe mbështetës ndaj të tjerëve;
- ruan dhe promovon vlerat e demokracisë, lirisë dhe përgjegjësisë individuale, barazisë dhe diversitetit, duke mbrojtur dhe duke u dhënë kuptim të gjitha prejardhjeve dhe kulturave të të gjithë fëmijëve dhe anëtarëve të komunitetit, si pasuri për mësimdhënien dhe nxënien;
- mbron interesat publike të ligjshme, të personave fizikë dhe juridikë.

Standardi 6. Menaxhimi i burimeve njerëzore dhe financiare

Përshkrimi i standardit

Drejtori i kopshtit menaxhon burimet njerëzore dhe financiare të kopshtit për të siguruar suksesin dhe mirëqenien e çdo fëmije. Ai përdor një sërë metodash dhe teknikash të menaxhimit të burimeve. Deleton të stafi detyra dhe monitoron përmbushjen e tyre. Kërkon të ndërtojë një kopsht të suksesshëm nëpërmjet bashkëpunimit efektiv brenda institucionit.

Drejtori lidh procedurat dhe proceset menaxheriale me qëllimet e arsimit për arsimin parashkollor dhe vizionin e vlerat e kopshtit. Ai qartëson stafin dhe ndan me ta vizionin për kopshtin, vlerat dhe detyrat operacionale në mbështetje të tyre. Drejtori përdor me efektivitet burimet financiare duke siguruar transparencë dhe llogaridhënie.

Dimensionet e standardit

- Menaxhimi i burimeve njerëzore;
- Përgjegjësitë dhe pritshmëritë e menaxhimit;
- Përdorimi me efektivitet i burimeve financiare;
- Transparenca dhe llogaridhënia.

Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Drejtori:

- është i pranishëm çdo ditë në institucion, duke modeluar menaxhimin e përditshëm dhe të frytshëm të stafit, fëmijëve, prindërve dhe komunitetit të gjerë;
- përdor në mënyrë efektive burimet e disponueshme, për të ndikuar maksimalisht në përmirësimin e cilësisë së



shërbimeve;

- monitoron veprimtarinë dhe shërbimet që ofron kopshti, për të promovuar përmbushjen e misionit dhe të vizionit të tij;
 - *vendos* pritshmëri për të gjithë stafin me qëllim përmirësimin e praktikave të menaxhimit;
 - *krijon* klimë pozitive, profesionale dhe kushte për përmirësim të vazhdueshëm, nëpërmjet komunikimit dhe mirëmenaxhimit të burimeve njerëzore;
 - *punon* për krijimin e një kulture të përmirësimit të shërbimit në institucion, duke u bazuar në dëshmi, përpjekje dhe risi;
 - *gjen* procedura funksionale në institucion për të mbështetur, për të udhëzuar dhe për të mbrojtur fëmijët;
 - *zbaton* praktika delegimi për shpërndarjen e burimeve në mënyrë sistematike sipas prioritetëve;
 - *menaxhon* kohën në mënyrë të tillë që të maksimizojë arritjen e objektivave;
 - *siguron* arritje nëpërmjet eliminimit të proceseve jofunksionale dhe përdorimit të efektshëm të procedurave standarde nga burimet njerëzore të institucionit;
 - *adreson* problematikat, dhe i zgjidh ato në kohën e duhur dhe me burimet e duhura;
 - *menaxhon* burimet financiare dhe burimet e tjera të kopshtit, në funksion të shërbimeve cilësore për fëmijët parashkollorë;
- është i përgjegjshëm, transparent dhe realizon procedurat e llogaridhënies personale në përdorimin e burimeve financiare;
- përdor teknologjitë e reja për të përmirësuar cilësinë dhe efikasitetin e menaxhimit;
- zhvillon dhe mirëmban të dhënat dhe sistemet e komunikimit për menaxhimin e kopshtit;
- siguron një funksionim cilësor të institucionit, duke përfshirë në vendimmarrje gjithë burimet njerëzore;
- zhvillon marrëdhënie produktive me bordin e kopshtit, njësinë e qeverisjes vendore, njësinë arsimore vendore etj.;
 - ndihmon komunitetin e kopshtit të njohë kuadrin ligjor, të drejtat dhe detyrat e tyre, në mënyrë që të promovojnë suksesin e fëmijëve;
 - *ruan* konfidencialitetin e të dhënave të kopshtit dhe privatësinë.

BIBLIOGRAFIA

AITSL, 2019, “Australian Professional Standard for Principals and the Leadership Profiles”, Carlton South;

Boeke Mongillo. M., Central Connecticut State University “Preparing School Leaders for Young Learners in the United States”;

CCSSO, 2013, “Standards for Educational Leaders: An Analysis”, Washington, DC;

GTC, 2012, “The Standards for Leadership and Management: supporting leadership and management development”;

<https://aminbles.blogspot.com/1977/06/best-practices-in-educational-leadership.html>;

https://www.academia.edu/21903105/Managing_and_Leading_in_Early_Childhood_Education_A_Study_of_Heads_of_Centers_in_Greece;

<https://www.readkong.com/page/slides/educational-leadership-capability-framework-8491534>;

https://www.researchgate.net/publication/259268146_Standards_for_Educational_Leaders_An_Analysis;

<https://www.slideserve.com/kieu/the-ontario-leadership-framework-2012>;

Kivunja, Ch., 2015, “Leadership in Early Childhood Education Contexts: Looks, Roles, and Functions” *Creative Education* 6 (16):1710-1717;

Kwok Sai Wong.T., 2006, “A case study of leadership of kindergarten principals in Hong Kong”;

MASR “Rregullore për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020;

NAEYC, 2019, “Professional Standards and Competencies for Early Childhood Educators”;

OECD, 2008, “Improving School Leadership”, Volume 1: Policy and practice;

URDHËR

Nr. 153, datë 1.4.2022

PËR NDALIMIN E PESHKIMIT NË LIQENIN E SHKODRËS

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, pikës 1, të nenit 13, të ligjit nr. 64/2012, datë 31.5.2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e peshkimit me çfarëdolloj mjeti dhe metode gjuetie, si dhe mbajtjen në bord, tranzitimin në barkë, zbarkimin e qëllim të dhe hedhjen në treg ose për konsum të të gjitha llojeve



të peshqve në liqenin e Shkodrës, nga data 1.4.2022 deri më 31.5.2022, me përjashtim të ngjallës e cila lejohet të peshkohet vetëm me grepa nga subjektet e pajisura me leje peshkimi nga Organizata e Menaxhimit të Peshkimit të liqenit të Shkodrës, siç është parashikuar në Planin e Menaxhimit të Ngjallës.

2. Ndalimin e peshkimit me çfarëdolloj mjeti dhe metode gjuetie, si dhe mbajtjen në bord, tranzitimin në barkë, zbarkimin e qëllimtë dhe hedhjen në treg ose për konsum të gjuhçës (cironkës) – *Alburnus Albidus Alborella* në liqenin e Shkodrës, për periudhën 1.4.2022 deri më 31.7.2022.

3. Për periudhën 1.6.2022 deri më 30.6.2022, ndalimin e peshkimit me rrjeta në fashën bregliqenore prej 300 m nga bregu.

4. Vendbazimi i varkave të peshkimit do të jetë sipas zonave të përcaktuara nga Organizata e Menaxhimit të Peshkimit të Liqenit të Shkodrës.

5. Për periudhën dymujore të lejimit të peshkimit të ngjallës, nga ana e Organizatës së Menaxhimit të Peshkimit të Liqenit të Shkodrës të ketë monitorim të sasive ditore të peshkuara.

6. Peshku i sekuestruar nga peshkimi i paligjshëm, të magazinohet në Qendrën e Parë të Ankandit të Peshkut, Shirokë dhe të ardhurat nga shitja e tij, pas dokumentimit nga Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, të përdoren nga Organizata e Menaxhimit të Peshkimit të liqenit të Shkodrës për blerje gazoili për mjetin lundrues, që përdoret për inspektimet e kryera për ruajtjen e liqenit.

7. Për zbatimin e këtij urdhri, të hartohet një Plan i Përbashkët Operativ Veprimi nga Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës në koordinim me Organizatën e Menaxhimit të Peshkimit të Liqenit të Shkodrës.

8. Organizata e Menaxhimit të Peshkimit të Liqenit të Shkodrës të marrë të gjitha masat e zhvendosjes së objekteve ku peshqit kanë lëshuar vezët, në rastet e rënies së nivelit të ujit në liqenin e Shkodrës.

9. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohet Drejtoria e Politikave dhe Programeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, Organizata e Menaxhimit të Peshkimit të Liqenit të Shkodrës, duke bashkëpunuar me strukturat e

qeverisjes vendore, Drejtorinë e Policisë së Rendit dhe atë Kufitare në qarkun e Shkodrës.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca

URDHËR
Nr. 154, datë 1.4.2022

**PËR MARRJEN E MASAVE KUFIZUESE
PËR PARANDALIMIN DHE
KONTROLLIN E SËMUNDJES SË
INFLUENCËS AVIARE NË SHPENDË,
NË MJEDISËT E HAPURA DHE NË
TREGJET E KAFSHËVE TË GJALLA**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës, të shkronjës “b”, të nenit 15, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e shitjes dhe tregtimit të shpendëve të gjallë në mjediset e hapura dhe tregjet e kafshëve të gjalla në qarqet Durrës, Dibër, Korçë, Fier, Vlorë, Tiranë dhe Shkodër.

2. Ndalimin e lëvizjes së shpendëve të gjallë nga ferma në fermë dhe nga ferma në tregjet e kafshëve të gjalla në qarqet Durrës, Dibër, Korçë, Fier, Vlorë, Tiranë dhe Shkodër.

3. Lejimin e lëvizjes së shpendëve të gjallë, vetëm për në thertore në qarqet Durrës, Dibër, Korçë, Fier, Vlorë, Tiranë dhe Shkodër, me dokumentacionin e parashikuar sipas legjislacionit në fuqi.

4. Urdhri nr. 145, datë 30.3.2022, “Për marrjen e masave kufizuese për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjes së influencës aviare në shpendë, në mjediset e hapura dhe në tregjet e kafshëve të gjalla”, shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Programeve të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.



Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca

URDHËR
Nr. 47, datë 2.4.2022

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28 dhe 29 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; dhe të pikave 2 dhe 3 të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Brendshme, zëvendësministrit të Brendshëm, z. Besfort Lamallari, nga data 4.4.2022 deri më datë 5.4.2022.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet zëvendësministri i Brendshëm z. Besfort Lamallari.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Bledar Çuçi

VENDIM
Nr. 8, datë 3.3.2022

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Vitore Tusha	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Altin Binaj	anëtar;
Përparim Kalo	anëtar;
Sonila Bejtja	anëtare;
Elsa Toska	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 3.3.2022 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 14 (B) 2021 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Bardhyl Ibra

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Drejtoria Vendore e Policisë së Qarkut Elbasan
Avokatura e Shtetit, Zyra Vendore Durrës

OBJEKTI: Konstatimi i shkeljes të së drejtës kushtetuese të aksesit dhe të sigurisë nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës, Gjykata Administrative e Apelit, si dhe Gjykata e Lartë.

Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2021-386, datë 18.3.2021, të Gjykatës së Lartë dhe kthimi i çështjes për gjykim në Gjykatën Administrative të Apelit.

BAZA LIGJORE: Nenet 31, 32, 33, 42, 43, 131, pika 1, shkronja “F”, 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2 dhe 142 pika, 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 27 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Elsa Toska, shqyrtoi parashtrimet e kërkuarit Bardhyl Ibra, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve të subjekteve të interesuara, Drejtorisë Vendore të Policisë së Qarkut Elbasan dhe Avokaturës së Shtetit, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,



VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në datën 18.3.2016 kërkuesi Bardhyl Ibra ka paraqitur kërkesëpadi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës, me palë të paditur Drejtorinë Vendore të Policisë së Qarkut Elbasan, me objekt: *‘Konstatimi i kryerjes së veprimeve të paligjshme nga ana e Drejtorisë së Policisë së Qarkut Elbasan, duke dërguar për publikim në televizione e media të ndryshme të vendit, të emrit të kërkuetit, të sendeve të sekuestruara, të cilat ndodhen në dosjen penale nr. 2476 të vitit 2014 në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, përveç që ishin të pavërteta, të kryera botërisht, në dëmin tim dhe të shoqatës që përfaqësoj, duke më cenuar shumë nderin, dinjitetin, reputacionin, shkaktuar strese dhe shqetësime të tjera shpirtërore të bëra nëpërmjet televizioneve disa herë radhazi* 2. Detyrimi i të paditurit për shpërblim të dëmit jopasuror në vlerën monetare në sasinë 2.000.000 lekë për cenim të nderit, dinjitetit, stresit të shkaktuar, vuajtjes fizike e shpirtërore mua dhe familjes time për shkak të dërgimit të këtij publikimi, për më tepër i padrejtë.”.

2. Nga dosja gjyqësore e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës rezulton se kjo gjykatë në datën 21.3.2016 ka mbajtur procesverbal për veprimet përgatitore, ku në zbatim të nenit 25, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” (ligji nr. 49/2012) ka konstatuar se padia nuk ishte me të meta nga pikëpamja formale. Po kështu, është vendosur njoftimi i të paditurit për padinë dhe aktet shoqëruese të saj, si dhe paraqitjen prej të paditurit, ndër të tjera, të prapësimeve me shkrim brenda 10 ditëve.

3. Seanca përgatitore është caktuar në datën 4.5.2016 dhe për këtë qëllim kërkuesi është njoftuar me letërthirrjen e datës 25.3.2016, e cila rezulton e pafirmosur nga ai dhe me shënimin “larguar”. Adresa e caktuar nga kërkuesi në kërkesëpadi ka qenë në qytetin e Elbasanit, ndërsa adresa e vendosur në letërthirrje është në qytetin e Gramshit. Edhe në zbatim me anë të të cilit kërkuesi ka depozituar kërkesëpadinë në gjykatën e shkallës së parë, adresa e tij figuron në Elbasan.

4. Në seancën përgatitore të datës 4.5.2016 Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës ka konstatuar se kërkuesi nuk ka paguar taksën

gjyqësore, nuk ka përcaktuar qartë dhe saktë adresën për njoftim, pasi fletëthirrja rezulton “larguar”, nuk ka paraqitur aktet në formën e kërkuar nga ligji, e për rrjedhojë ka vlerësuar se padia është me të meta, si dhe nuk plotëson kushtet formale të paraqitjes së saj. Me vendimin nr. 82-2016-574, datë 4.5.2016, kjo gjykatë, në zbatim të nenit 39, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 49/2012, ka vendosur: *“Mospranimin e padisë, pasi nuk plotëson kushtet e nenit 154 të Kodit të Procedurës Civile. Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë. Kundër këtij vendimi lejohet ankim i veçantë në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, duke filluar nga e nesërmyja e marrjes djeni. Për palët në mungesë ky afat fillon nga dita e komunikimit të vendimit.”*. Në fund të vendimit është shënuar, se: *“vendimi mori formë të prerë datë 30.5.2016”*. Në dëftesën e komunikimit të vendimit nr. 82-2016-574, datë 4.5.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, drejtuar kërkuetit, është vendosur adresa në qytetin e Gramshit, ndërkohë që në këtë dëftesë komunikimi figuron vula postare e qytetit të Librazhdit.

5. Në datën 26.4.2019 kërkuesi ka paraqitur në Gjykatën Administrative të Apelit kërkesën me objekt: *“Konstatimi i shkëlqes të së drejtës kushtetuese të moskomunikimit të vendimit nr. 82-2016-574, datë 4.5.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës edhe sot e kësaj dite, duke kaluar afatet ligjore, duke ndenjur dosja për afër tre vite në sirtarët e kësaj gjykate, duke i mobuar të drejtën e aksesit dhe të sigurisë juridike për t’iu drejtuar gjykatave më të larta të sistemit gjyqësor, si dhe në Gjykatën Kushtetuese e më tej. Kërkoj të merret informacion për procedurat e ndjekura nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës, në bazë të nenit 399/4 të Kodit të Procedurës Civile. Detyrimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës për t’i komunikuar kërkuetit menjëherë kopjen e vendimit të mësipërm dhe ndonjë akt tjetër procedural.”*

6. Në po të njëjtën datë (26.4.2019) kërkuesi ka paraqitur edhe një kërkesë ankimore drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit kundër vendimit nr. 82-2016-574, datë 4.5.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës. Kjo kërkesë ankimore ka pasur si objekt: *Konstatimin e kryerjes së veprimeve të paligjshme nga ana e Drejtorisë së Policisë së Qarkut Elbasan, duke dërguar për publikim në televizione e media të ndryshme të vendit, të emrit të kërkuetit, të sendeve të sekuestruara, të cilat ndodhen në dosjen penale nr. 2476 të vitit 2014 në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, përveç që ishin të pavërteta, të kryera*



botërisht, në dëmin tim dhe të shoqatës që përfaqësoj, duke më cenuar shumë nderin, dinjitetin, reputacionin, shkaktojnë stres dhe shqetësime të tjera shpirtërore të bëra nëpërmjet televizioneve disa herë radhazi” 2. Detyrimin e të paditurit për shpërblim të dëmit jopasuror në vlerën monetare në sasinë 2.000.000 lek për cenim të nderit, dinjitetit, stresit të shkaktojnë, vuajtjes fizike e shpirtërore mua dhe familjes time për shkak të dërgimit të këtij publikimi për më tepër i padrejtë.”

7. Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur njoftimin e palëve për përbërjen e trupit gjykues, datën, orën dhe vendin e shqyrtimit të çështjes, me sqarimin se deri në 5 ditë para seancës palët kanë të drejtë të paraqesin parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim. Për këtë qëllim, në datën 15.5.2019, në bazë të nenit 49, pika 2, të ligjit nr. 49/2012, është bërë shpallja e seancës.

8. Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. 134, datë 30.5.2019 ka vendosur: “Nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor dhe dërgimin e çështjes pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës (kancelarisë së kësaj gjykate) për të trajtuar kërkesën objekt gjykimi.”. Gjykata Administrative e Apelit ka arsyetuar si vijon: “Referuar parashikimeve të nenit 10 të ligjit nr. 49/2012 (...)2. Gjykata Administrative e Apelit shqyrton: a) ankimet kundër vendimeve të gjykatës administrative të shkallës së parë; b) në shkallë të parë, mosmarrëveshjet me objekt aktet nënligjore normative, si dhe raste të tjera të parashikuara me ligj”. Ndërsa sipas nenit 9 të ligjit nr. 49/2012 “Gjykata në çdo fazë dhe shkallë të gjyqimit, qoftë edhe kryesisht, kur konstaton se çështja nuk bën pjesë në juridiksionin gjyqësor, merr vendim për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit dhe dërgimin e akteve organit kompetent(...)”. Referuar dispozitave procedurale të lartë cituara, Gjykata Administrative e Apelit ka vlerësuar se kërkesa e kërkuarit duhet të nxirret jashtë juridiksionit gjyqësor dhe t’i dërgohet për trajtim për veprime administrative Kancelarisë, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.”

9. Në datën 24.10.2019 kërkuari ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, e cila me vendimin nr. 00–2021–386, datë 18.3.2021, ka vendosur: “Mospranimin e ankimit të veçantë ushtruar nga kërkuari, Bardhyl Ibra kundër vendimit nr. 134, datë 30.5.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit”. Në vendimin e saj Gjykata e Lartë ka arsyetuar si vijon: “Kolegji sjell në vëmendje se pala kërkuare, Bardhyl Ibra ka paraqitur ankim të veçantë ndaj vendimit nr. 134, datë 30.5.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit, me mjetin e cilësuar prej tij “Rekurs” drejtuar Kolegjit Administrativ të Gjykatës së

Lartë. Në nenin 9, pika 2, fjalia e parë të ligjit nr. 49/2012, parashikohet se ndaj vendimit të gjykatës që ka nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit “mund të bëhet ankim i veçantë në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë...Kolegji thekson se, Gjykata Administrative e Apelit ka bërë një vlerësim dhe analizë të fakteve dhe me të drejtë ka disponuar me nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, në zbatim të nenit 9 të Ligjit nr. 49/2012, duke ja dërguar organit kompetent, Kancelarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, për ta trajtuar në rrugë administrative kërkesën në lidhje me komunikimin e vendimit gjyqësor nr. 82-2016-574, datë 4.5.2016 të po kësaj gjykate. Gjithashtu, me të drejtë Gjykata Administrative e Apelit ka konkluduar, duke mos e shqyrtuar në themel kërkesën e paraqitur nga Bardhyl Ibra, pasi nuk plotëson kushtet dhe kriteret e parashikuara nga neni 10, pika 2 i ligjit nr. 49, datë 3.5.2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, pasi nuk ka qenë përpara shqyrtimit të një ankimit të ushtruar ndaj vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë dhe nuk ishte përpara një kërkesë padie për kundërshtimin e një akti nënligjor normativ. Mbështetur sa më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë konkludon se vendimi nr. 134, datë 30.5.2019, i Gjykatës Administrative të Apelit, me të cilin është nxjerrë jashtë juridiksionit gjyqësor çështja, duhet të libet në fuqi.”

10. Në datën 19.8.2021 kërkuari i është drejtuar me shkresë Gjykatës së Lartë, e cila në datën 23.9.2021, me shkresën nr. 2815/1, e ka informuar atë, se: “sipas verifikimeve në librat manualë dhe elektronikë rezultojnë se që në datën 20.4.2021 ka qenë e mundur marrja e vendimit nga palët e interesuara, si dhe e publikuar në faqen tonë të internetit.”.

11. Kërkuari i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata), me kërkesë sipas objektit të mësipërm, në datën 18.8.2021 (sipas shënimit të shërbimit postar).

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

12. **Kërkuari** në mënyrë të përmbledhur ka pretenduar se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor në elementet e mëposhtme:

12.1. E drejta e aksesit në gjykim, pasi Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Gjykata Administrative e Apelit dhe Gjykata e Lartë nuk i kanë komunikuar kërkuarit vendimet e tyre. Gjykata e shkallës së parë dhe ajo e apelit duhet të njoftonin kërkuarin me një sërë formash të



parashikuara në Kodin e Procedurës Civile (KPC) dhe ligjin nr. 49/2012, si dhe me anë të shpalljes. Gjithashtu, Gjykata e Lartë ka legjitimuar shkeljet e të dyja gjykatave më të ulëta. Po kështu, të tria gjykatat nuk kanë njoftuar kërkuesin për datën e gjykimit dhe përbërjen e trupit gjykues.

12.2. *Standardi i arsyetimit të vendimit*, për arsye se në vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit, në kundërshtim me nenin 142 të Kushtetutës, nuk përputhen me njëra-tjetrën pjesët hyrëse, arsyetuese dhe dispozitivi i vendimit, si dhe nuk është njohur e drejta e ankimit ose e rekursit. Kjo gjykatë nuk ka shqyrtuar themelin e çështjes dhe nuk është shprehur për moskomunikimin e kopjes së vendimit nga ana e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës. Nxjerrja e çështjes jashtë juridiksionit, si dhe dërgimi për kompetencë kancelarit janë të pabazuara në ligj, pasi nuk është kompetencë e kancelarit të shqyrtojë çështje të tilla.

12.3. *E drejta për t'u dëgjuar nga Gjykata e Lartë*, pasi mungesa e njoftimeve të akteve nuk mund të sjellë mohimin e së drejtës për t'u dëgjuar dhe për të marrë përgjigje për shkaqet e ngritura në ankim ose rekurs. Për rrjedhojë, ka pasur shkelje edhe të së drejtës së aksesit në Gjykatën e Lartë dhe të së drejtës për t'u mbrojtur.

12.4. *E drejta e gjykimit brenda afatit të arsyeshëm* për shkak të mosshqyrtimit të çështjes brenda afatit të arsyeshëm nga gjykatat e faktit.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

13. Çështja e legjitimitimit është një ndër aspektet kryesore që lidhet me vënien në lëvizje të një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “I” dhe pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

14. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat

negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

15. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë të natyrës kumulative, pra mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

16. Në çështjen konkrete, kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

17. Një tjetër kriter paraprak, që duhet të përmbushet nga individ i përpara se t'i drejtohet kësaj Gjykate, lidhet me *shterimin e mjeteve juridike*. Sipas nenit 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës, Gjykata vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese, që individ i pretendon se i janë cenuar nga akti i pushtetit publik. Qëllimi i këtij neni të Kushtetutës është, ndër të tjera, të mundësojë, brenda sistemit gjyqësor të zakonshëm, parandalimin ose riparimin e shkeljeve të pretenduara, përpara se të tilla pretendime të paraqiten në Gjykatën Kushtetuese (*sib vendimet nr. 15, datë 7.5.2018; nr. 54, datë 24.7.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Gjykata ka pohuar se mbrojtja kushtetuese ka një funksion *subsidiar* dhe ajo mund të kërkohet vetëm për një vendim përfundimtar, të çfarëdolloj forme, që përmbyll procesin gjyqësor. Cenimi i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apeliave dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprake çojnë në një rëndim të mëtëjshëm ose në tejzgjatjen e cenimit të kësaj të drejte (*sib vendimin nr. 29, datë 30.3.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në lidhje me sa më lart, kërkuesi në mënyrë të përmbledhur ka pretenduar cenimin e: i. *së drejtës së aksesit në gjykim* për shkak të mosnjoftimit të vendimit nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë; ii. *standardit të arsyetimit të vendimit*, për arsye se Gjykata Administrative e Apelit nuk ka shqyrtuar themelin e çështjes, nuk është shprehur për



moskomunikimin e kopjes së vendimit nga ana e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës dhe nuk e ka bazuar në ligj dërgimin e çështjes për kompetencë kancelarit; iii. *së drejtës për t'u dëgjuar nga Gjykata e Lartë*, pasi mungesa e njoftimeve të akteve i ka mohuar të drejtën për t'u dëgjuar dhe për të marrë përgjigje për shkaqet e ngritura në rekurs; iv. *së drejtës së gjyqimit brenda një afati të arsyeshëm*, për shkak të mosshqyrtimit të çështjes brenda afatit të arsyeshëm nga gjykatat e faktit.

20. Në çështjen konkrete Gjykata vëren se kërkuesi i është drejtuar me kërkesëpadi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, duke kërkuar *“konstatimin e kryerjes së veprimeve të paligjshme nga ana e Drejtorisë së Policisë së Qarkut Elbasan dhe shpërblimin e dëmit jopasuror.”*. Nga dosja gjyqësore rezulton se kërkuesi nuk ka marrë dijeni për seancën përgatitore të datës 4.5.2016 të zhvilluar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës, pasi adresa e vendosur në fletëthirrje ka të shënuar qytetin e Gramshit, ndërkohë që kërkuesi, sipas kërkesëpadisë, është banues në qytetin e Elbasanit. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës, pasi ka konstatuar se padia ishte me të meta, me vendimin nr. 82-2016-574, datë 4.5.2016, ka vendosur mospranimin e saj. Sipas akteve të dosjes, edhe komunikimi i vendimit të kësaj gjykate për mospranimin e padisë i është dërguar kërkuetit në datën 4.5.2016 në qytetin e Gramshit dhe jo në Elbasan, ku ai është banues.

21. Kërkuesi, pasi ka marrë dijeni për vendimin gjyqësor të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës për mospranimin e kërkesëpadisë nuk rezulton të ketë bërë ankim ose kërkesë për rivendosje në afat të ankimit, por i është drejtuar në mënyrë të drejtpërdrejtë Gjykatës Administrative të Apelit dhe më pas Gjykatës së Lartë me një kërkesë, ku kundërshtonte veprimet administrative të administratës gjyqësore për mungesën e njoftimit të tij.

22. Siç është përmendur më lart (*shih paragrafin 5*), kërkuesi, në datën 26.4.2019, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit, duke kërkuar, ndër të tjera, konstatimin e shkeljes të së drejtës për t'u njoftuar për vendimin gjyqësor. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 134, datë 30.5.2019, ka vendosur nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor dhe dërgimin e saj për veprime administrative në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës (kancelarinë e kësaj

gjykate) për të trajtuar kërkesën objekt gjykimi. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Lartë me vendimin nr. 00–2021–386, datë 18.3.2021.

23. Për sa më sipër, Gjykata vëren se thelbi i padisë së kërkuetit, konkretisht konstatimi i veprimeve të paligjshme të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Elbasan dhe shpërblimi i dëmit jopasuror nuk është gjykuar në themel, pasi kërkesëpadia e tij nuk është pranuar për shkak të të metave në paraqitjen e saj. Nga ana tjetër, kërkueti, pasi ka marrë dijeni për vendimin e mospranimin të kërkesëpadisë, megjithëse kishte në dispozicion mjetin ligjor procedural të ankimit ose të kërkesës për rivendosje në afat të ankimit, ka zgjedhur një rrugë procedurale të ndryshme, duke iu drejtuar fillimisht gjykatës së apelit në mënyrë të drejtpërdrejtë me kërkesë për konstatimin e cenimit të së drejtës së njoftimit të vendimit dhe më pas Gjykatës së Lartë.

24. Bazuar në sa më lart, kërkueti nuk ka arritur t'i provojë Gjykatës që ankimi individual kushtetues i paraqitur prej tij ishte mjeti i fundit efektiv për rivendosjen në vend të të drejtave të pretenduara si të cenuara dhe se nuk ekzistojnë më mjete dhe rrugë ligjore për mbrojtjen e këtyre të drejtave. Vendimet gjyqësore që ai ka kundërshtuar para Gjykatës nuk janë vendime përfundimtare, sipas kuptimit të nenit 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës. Për sa i përket themelit të çështjes, Gjykata vlerëson se kërkueti nuk i ka ezauruar mjetet ligjore të disponueshme që parashikon legjislacioni procedural përkatës, dhe, për rrjedhojë nuk ka marrë përgjigje përfundimtare nga pikëpamja e kushtetutshmërisë për themelin e çështjes, që të mundësonte kontrollin kushtetues ndaj saj.

25. Në lidhje me pretendimin e kërkuetit për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm, Gjykata vëren se ai nuk ka dhënë asnjë argument kushtetues konkret për këtë pretendim, duke mos specifikuar se për cilat shkallë gjykimi ka pretendime për tejzgjatje të procesit. Për pasojë, Gjykata çmon se ky pretendim nuk është ngritur në nivel kushtetues.

26. Si përfundim, bazuar në sa më sipër, Gjykata vlerëson se kërkesa e paraqitur prej kërkuetit duhet rrëzuar.



PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijuese, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 3.3.2022.

Shpallur më 4.4.2022.

Kryetare: Vitore Tusha

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Përparim Kalo, Altin Binaj, Elsa Toska, Sonila Bejtja

VENDIM

Nr. 47, datë 23.3.2022

**MBI PAJISJEN ME CERTIFIKATË TË
GARANCISË SË ORIGINËS PËR
IMPIANTIN E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE HEC “BANJË”,
TË SHOQËRISË “DEVOLL
HYDROPOWER” SHA, PËR
PERIUDHËN 1.1.2021–31.12.2021**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të nenit 16, pika 6, të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; të nenit 14, të “Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”, miratuar nga Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE) me vendimin nr. 229, datë 20.12.2019, dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.3.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Licencimit, Mbikëqyrjes dhe Autorizimeve me nr. 382/3 prot., datë 18.3.2022,

“Mbi pajisjen me certifikatë të garancisë së origjinës për impiantin e prodhimit të energjisë elektrike HEC ‘Banjë’, të shoqërisë ‘Devoll Hydropower’ sh.a., për periudhën 1.1.2021–31.12.2021”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Devoll Hydropower” sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 345 prot., datë 2.3.2022, ka paraqitur kërkesën për t’u pajisur me certifikatë të garancisë së origjinës për HEC “Banjë”, për periudhën 1.1.2021–31.12.2021.

- Referuar kërkesës së shoqërisë, sasia e energjisë elektrike e prodhuar nga HEC “Banjë” për periudhën 1.1.2021–31.12.2021 është 258,712 mwh, por sasia e energjisë elektrike që do të merret në konsideratë në këtë vendimmarrje është sasia faktike prej 258,632 mwh, e prodhuar nga HEC “Banjë” për periudhën 1.1.2021–31.12.2021, e raportuar nga OST sh.a., në shkresën nr. 1721/1 prot., datë 16.3.2022.

- Në kuptim të nenit 16, pika 6, të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme” dhe nenit 11, pika 3, të “Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”, garancia e origjinës lëshohet bazuar në të dhëna të kuptueshme dhe informacion të duhur për të certifikuar origjinën e energjisë elektrike të furnizuar nga prodhuesi, si dhe të dhënat e matura të certifikuara nga Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 132, datë 10.8.2020, miratoi kualifikimin e impiantit të prodhimit të energjisë elektrike HEC “Banjë”, të shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a., si dhe pajisi me certifikatë të garancisë së origjinës impiantin e prodhimit të energjisë elektrike HEC “Banjë”, të shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a., për një afat 12-mujor.

- Referuar nenit 14.2, të “Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”, pas lëshimit të certifikatës së parë të garancisë së origjinës, çdo aplikues që paraqet në ERE një kërkesë për certifikatë garancie origjine do të depozitojë në ERE, për qëllime të këtij aplikimi, vetëm dokumentacionin që ka pësuar ndryshim referuar kërkesave të nenit 7, të kësaj rregulloreje.



- Sa rezulton nga kërkesa e shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a., nuk është bërë me dije ndonjë ndryshim në impiantin prodhues HEC “Banjë”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të pajisë me certifikatë të garancisë së origjinës impiantin e prodhimit të energjisë elektrike HEC “Banjë”, të shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a. për një periudhë 12-mujore (1.1.2021–31.12.2021), për sasinë e prodhuar të energjisë elektrike 258,632 mwh.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara.

Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 48, datë 23.3.2022

**MBI SHTYRJEN E VENDIMARRJES
SË BORDIT TË ERE-s PËR KËRKESËN
E SHOQËRISË “HERA” SHPK, PËR
TRANSFERIMIN E PLOTË TË
LICENCËS NR. 49, SERIA NPM07P,
DHËNË ME VENDIMIN E BORDIT NR.
61, DATË 2.11.2007, “PËR NDËRTIM,
INSTALIM, SHFRYTËZIMIN DHE
PRODHIMIN E ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA CENTRALE ME ERË
(PROJEKTI KAPPET)”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 67, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i

Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2017; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.3.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 382/2-1 prot., datë 18.3.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizime dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë “HERA” sh.p.k., për transferimin e plotë të licencës nr. 49, seria NPM07P, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 61, datë 2.11.2007, të ndryshuar, “Për ndërtim, instalim, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale me erë (projekti KAPPET)”, të ndryshuar,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 240, datë 2.12.2021, vendosi:

1. Të fillojë procedurën për transferimin e plotë të licencës së shoqërisë “HERA” sh.p.k., me nr. 49, seria NPM07P, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 61, datë 2.11.2007, të ndryshuar, “Për ndërtim, instalim, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale me erë (projekti KAPPET)”, me kapacitet të instaluar 150 mw, për një afat 30-vjeçar.

2. Vendimi përfundimtar për transferimin e licencës së shoqërisë “HERA” sh.p.k. do të merret pasi Bordi i ERE-s të jetë shprehur në lidhje me shtyrjen ose jo të afateve të plotësimit të kushteve të vendimit nr. 61, datë 2.11.2007, të ndryshuar.

- Me *email-in* e datës 17.3.2022, në ERE kanë mbërritur: shkresa e protokolluar me tonën me nr. 65/5 prot., datë 18.3.2022, shkresa nr. 65/6 prot., datë 18.3.2022 dhe shkresa nr. 65/7 prot., datë 18.3.2022, të shoqërive “HERA” sh.p.k. dhe “SOT AL” sh.p.k. të cilat kanë vijuar me depozitimin e dokumentacionit shtesë që i është kërkuar nga ERE, në lidhje me këtë praktikë.

- Me qëllim shqyrtimin e këtij dokumentacioni për të dalë më pas me propozimin përfundimtar, në lidhje me kërkesën për transferimin e licencës së shoqërisë “HERA” sh.p.k. te shoqëria “SOT AL” sh.p.k. vlerësojmë shtyrjen me 30 ditë pune të afatit të vendimarrjes finale të Bordit të ERE-s, në mbështetje të nenit 67, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në lidhje me këtë kërkesë.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s



VENDOSI:

1. Të shtyjë me 30 (tridhjetë) ditë pune vendimmarrjen e Bordit të ERE-s, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “HERA” sh.p.k., për transferimin e licencës nr. 49, seria NPM07P, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 61, datë 2.11.2007, të ndryshuar, “Për ndërtim, instalim, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale me erë (projekti KAPPET)”.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 49, datë 23.3.2022

**MBI SHTYRJEN E AFATIT TË
VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-
s MBI APLIKIMIN E SHOQËRISË
“KARAVASTA SOLAR” SHPK, PËR
LICENCIM NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA CENTRALI
FOTOVOLTAIK, ME VENDNDODHJE
NË ZONËN E REMASIT – KARAVASTA,
LUSHNJË DHE LIBOFSHË, FIER, ME
KAPACITET TË INSTALUAR 140 mw**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 13, pikat 1 dhe 3, dhe nenit 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.3.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 382/1 prot., datë 17.3.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi shtyrjen e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s mbi aplikimin e

shoqërisë “Karavasta Solar” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai, me vendndodhje në zonën e Remasit – Karavasta, Lushnjë dhe Libofshë, Fier, me kapacitet të instaluar 140 mw”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 261, datë 21.12.2021, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Karavasta Solar” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai, me vendndodhje në zonën e Remasit – Karavasta, Lushnjë dhe Libofshë, Fier, me kapacitet të instaluar 140 mw.

- Me shkresën nr. 1129/2 prot., datë 30.12.2021, ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimmarrjen e Bordit të ERE-s e po ashtu për zhvillimin e një seance dëgjimore më datë 10.1.2022, ora 14:00, për të sqaruar dokumentacionin e konstatuar si të munguar apo të plotësuar pjesërisht. Në seancë është ftuar dhe OST sh.a., me qëllim sqarimin e fazës në të cilën ndodhet procedura për marrjen e miratimit përfundimtar të pikës së lidhjes së impiantit të shoqërisë “Karavasta Solar” sh.p.k. me rrjetin e transmetimit.

- Pas zhvillimit të seancës dëgjimore, shoqëria “Karavasta Solar” sh.p.k. ka depozituar dokumentacion dhe informacion me shkresën e protokolluar në ERE nr. 48/2 prot., datë 27.1.2022.

- Dokumentacioni i depozituar nga shoqëria “Karavasta Solar” sh.p.k. nuk plotësonte tërësisht kërkesat e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, ndaj ERE iu drejtua shoqërisë me shkresën nr. 48/3 prot., datë 15.2.2022, duke i evidentuar dokumentet që mbeten pa u plotësuar tërësisht dhe/ose kanë nevojë për informacion shtesë. Në nenin 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, është parashikuar dhe zgjatja e afatit për pranimin ose refuzimin për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike për aplikuesin rasti pas rasti, konkretisht:

“3. Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit të përcaktuar në pikat 1 dhe 2, të këtij neni kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë pune.”.



- Duke qenë se shoqëria “Karavasta Solar” sh.p.k. ka plotësuar një pjesë të konsiderueshme të dokumentacionit të kërkuar nga Rregullorja, vlerësohet që të zgjatet me 30 (tridhjetë) ditë pune afati i vendimmarrjes së Bordit mbi aplikimin e shoqërisë për t’u licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, duke i dhënë kështu mundësinë shoqërisë që të plotësojë dhe dokumentacionin e mbetur ende pa u plotësuar i cili duhet të depozitohet brenda 20 (njëzet) ditëve pune.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë me 30 (tridhjetë) ditë pune afatin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s mbi aplikimin e shoqërisë “Karavasta Solar” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me vendndodhje në zonën e Remasit – Karavasta, Lushnjë dhe Libofshë, Fier, me kapacitet të instaluar 140 mw.

2. Shoqëria “Karavasta Solar” sh.p.k. të depozitojë në ERE dokumentacionin e munguar brenda 20 (njëzet) ditëve pune.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

LISTA EMËRORE PARAPRAKE E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË TË CILËVE SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË SEGMENTIT “SHKODËR (MBIKALIMI I TRENT)-MES”

Nr.	Pronari			ZK	Nr. i pasurisë	Sipërfaqe totale e pronës m ²	Të dhënat e pasurisë				VLERA TOTAL E (lekë)	Adresa e pronarit	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri				Sip. m ²	çmimi m ²	Vlera në lek	Lloji i pasurisë			
1	Bashkëpronarët Zalli			8593	17/339	1522	287	8511	2,442,657	truall	2,442,657	Shkodër-Golem	Konfirmuar nga ASHK-ja
2	Frangë	Kol	Pali	1790	112/6	250	137.2	421	57,761.20	truall	57,761.20	Shkodër-Golem	Konfirmuar nga ASHK-ja
Vlera paraprake									2,500,418		2,500,418		

KËRKESË

Nr. 213/5, datë 5.4.2022

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Rikonstruksioni i segmentit Shkodër (mbikalimi i trenit) – Mes’”.

Subjekti kërkuar i këtij projekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraparak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, për pasuritë e llojit “truall”.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 2 500 418 (dy milionë e pesëqind mijë e katërqind e tetëmbëdhjetë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT
TË POSAÇËM TË SHPRONËSIMEVE
Erlis Hereni

**VENDIM***(i shkurtuar)*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me vendimin nr. 1 (64-2022-95), datë 25.1.2022, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar për shtetasen Arvena Akulli, e datëlindjes 21.1.1980, lindur dhe banuese në Njësinë Administrative Kolonjë, Bashkia Lushnjë, dhe vendosjen e saj nën kujdestarinë dhe përfaqësinë ligjore të kërkuesit Alban Akulli.

VENDIM*(i shkurtuar)*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 6 (1013), datë 21.3.2022, vendosi pranimin e kërkesës për marrjen e masës së përkohshme dhe urgjente dhe me efekt të menjëhershëm ekzekutues të kërkueses Shqiponja Likaj; caktimin si kujdestare të përkohshme ligjore për shtetasen madhore Elvira Marinaj, e datëlindjes 15.9.1991, motrën e saj shtetasen Shqiponja Likaj, për të kryer të gjitha veprimet juridike të saj, në emër dhe për llogari të shtetasen madhore Elvira Marinajn dhe për ta përfaqësuar atë, në çfarëdolloj institucioni publik a privat, derisa të shqyrtohet me

vendim përfundimtar çështja gjyqësore, me objekt heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasen Elvira Marinaj dhe caktim kujdestari.

NDREQJE GABIMI MATERIAL

Në ligjin nr. 10/2022, datë 27.1.2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9863, datë 28.1.2008, ‘Për ushqimin’, të ndryshuar”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 29, datë 22.2.2022, bëhet korrigjimi, si më poshtë:

në nenin 5, referenca “Në nenin 51, pas pikës 6 shtohen pikat 7 dhe 8” **bëhet:** “Në nenin 51, pas pikës 7 shtohen pikat 8 dhe 9”.

NDREQJE GABIMI MATERIAL

Në ligjin nr. 11/2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10465, datë 29.9.2011, ‘Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë’, të ndryshuar”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 29, datë 22.2.2022, bëhet korrigjimi, si më poshtë:

në nenin 10, referenca “Në nenin 88, pika 1, shkronja “b”” **bëhet:** “Në nenin 88, pika 2, shkronja “b””.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 384 lekë